

dhjetor 2007

Kosova në udhëkryq

Perceptimet e konfliktit, qasja në
drejtësi dhe mundësitë për paqe në
Kosovë



VENDI SIGURTË
BEZBEDNOMESTO
SAFEPLACE





Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) është një organizatë joqeveritare kosovare që promovon përfshirjen e qytetarëve të Kosovës në proceset shoqërore dhe ato të vendim-marrjes përmes programeve të ideuara që përqëndrojnë vëmendjen në vlerat dhe funksionimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike.



Saferworld është një organizatë e pavarur joqeveritare që punon me qeveritë dhe shoqëritë civile në planin ndërkombëtar për të hulumtuar, promovuar dhe zbatuar strategji të reja për të rritur sigurinë e njerëzve dhe për të parandaluar dhunën e armatosur.

iv *Perceptimet e konfliktit, qasja në drejtësi dhe mundësitë për paqe në Kosovë*

© 2007 Forumi për Iniciativa Qytetare dhe Saferworld



Kosova në udhëkryq Perceptimet e konfliktit, qasja në drejtësi dhe mundësitë për paqe në Kosovë

Mirënjohje

Ky raport është shkruar nga ekipi i projektit VendiSigurtë në Forumin për Iniciativa Qytetare dhe Saferworld. Ne dëshirojmë që t'i falënderojmë Qeveritë e Mbretërisë së Bashkuar dhe të Gjermanisë për financimin e këtij hulumtimi përmes përkrahjes së tyre për projektin VendiSigurtë.

Ne gjithashtu dëshirojmë që të falënderojmë organizatat joqeveritare në vijim për përkrahjen e tyre të çmueshme në hulumtimin për këtë raport:

Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CCSD), Komunikimi për Zhvillim të Shoqërisë (CSD), Community Building Mitrovica (CBM), Qendra për Zhvillimin e Komunitetit të Biznesit (CBDC), Iniciativa për Progres (INPO), Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC) dhe Rrjeti Rinor nga Gjilani, Këshilli për Paqe dhe të Drejta të Njeriut (PHRC), dhe Syri i Vizionit.

Së fundi, ne dëshirojmë të shprehim falënderimet tona për interesin e treguar nga Divizioni për Hulumtim dhe Analiza nën Departamentin e Politikave të Minsitrisë së Punëve të Brendshme të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe Drejtorisë për Analizë të Politikave të Shërbimit Policor të Kosovës gjatë hulumtimit në këtë raport.

Përmbledhje ekzekutive

Kosova ndodhet në një udhëkryq. Shkaktarët kryesor të konfliktit duke përfshirë vendimin fundamental për statusin e ardhshëm, duhet të adresohen në mënyrë që ta shpiejn Kosovën drejt një të ardhme më prosperuese dhe stabile. Ky raport është bazuar në një metodologji¹ gjithpërfshirëse të analizës së konfliktit dhe ky është kulminacioni i hulumtimit, këshillave dhe sygjerimeve nga organizatat e shoqërisë civile në tërë Kosovën. Ky raport i shqyrton shkaktarët potencial të konfliktit dhe mundësitë për paqe në pesë kategori kryesore: statusi i ardhshëm i Kosovës; siguria dhe drejtësia; politika dhe qeverisja; shoqëror dhe kulturor; dhe ekonomik dhe të jetesës.

Hulumtimi i cili është zhvilluar në mes të muajve shtator dhe tetor 2007 nga Saferworld, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe tetë OJQ² tjera lokale, ka përfshirë pjesëmarrës nga komunitetet kryesore etnike të Kosovës, OJQ-të dhe punëtorët e sektorit të sigurisë dhe drejtësisë në seminare punuese, fokus grupe dhe intervista. Si i tillë, ky hulumtim reflekton perceptimet e popullit dhe punëtorëve të sektorit të sigurisë dhe drejtësisë të përfshirë në hulumtim, më shumë se sa pikëpamjet e autorëve apo donatorëve të tyre. Shumica e procesit është shoqëruar nga përfaqësuesit e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ).

Statusi i ardhshëm i Kosovës

‘Statusi Përfundimtar’ i përshkon shqetësimet e popullit siç janë shprehur përgjatë këtij raporti. Lidhet me të gjitha sferat e jetës në Kosovë – shoqërore, ekonomike, kulturore, politike dhe të sigurisë. Njerëzit janë të shqetësuar në mënyrë të arsyeshme se si do të ndikojë zgjidhja e statusit në jetën e tyre, dhe janë të frustruar se me shtyrjen e zgjidhjes së tij po pengohen përpjekjet për të përmirësuar situatën në Kosovë. Shumë njerëz ndihen të përjashtuar nga niveli i lartë i negociatave ndërkombëtare dhe të pafuqishëm që të ndikojnë në vendimet e ndërmarra nga SHBA, Rusia dhe BE për Kosovën.

- Administrata ndërkombëtare dhe IPVQ-të duhet t’i adresohen kësaj heqjeje të së drejtës, duke i siguruar popullit të Kosovës informata më të mira në lidhje me procesin e statusit përfundimtar dhe të hapin mundësinë që të diskutohet në publik.

Siguria dhe drejtësia

Sipas pjesëmarrësve në hulumtim të këtij raporti, dobësitë e sektorit të sigurisë dhe drejtësisë ndikojnë që njerëzit të mos i zgjidhin problemet e tyre përmes gjykatave, duke u nxitur disa që “të marrin ligjin në duart e tyre”. Ndarja e paqartë e kompetencave në mes të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare shkakton huti

¹ Shih Aneksin A: Metodologjia për një përshkrim të detajuar të definicioneve dhe metodologjisë së shfrytëzuar.

² Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CCSD) (me zyrë në Mitrovicë); Qendra për Zhvillim Social (CSD) (me zyrë në Graçanicë); Community Building Mitrovica (CBM); Qendra për Zhvillimin e Biznesit në Komunitet (CBDC) (me zyrë në Gjakovë); Iniciativa për Progres (INPO) (me zyrë në Ferizaj); Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Kosovë (KCIC) dhe Rrjeti i të Rinjve në Gjilan (me zyrë në Gjilan); Këshilli për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut (me zyrë në Prizren); Syri i Vizionit (me zyrë në Pejë).

ii *Perceptimet e konfliktit, qasja në drejtësi dhe mundësitë për paqe në Kosovë*

rreth asaj se kush është përgjegjës për cilat aspekte të ofrimit të sigurisë dhe sistemin e drejtësisë, duke e vështirësuar llogaridhënien e institucioneve dhe duke krijuar hapësirë për korrupsion. Është me rëndësi që IPVQ dhe administrata ndërkombëtare në Kosovë të sqarojnë dhe komunikojnë ndarjen e kompetencave të sektorit të sigurisë dhe drejtësisë ne mes veti.

Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) është njëri prej institucioneve më të besuara në Kosovë, por ky sukses është duke u nënvlerësuar nga kapaciteti i dobët dhe korrupsioni i perceptuar në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtja joadekuate e dëshmitarëve dhe viktimave. Kushtet të cilat lejojnë korrupsionin të mbizotërojnë përfshijnë mungesën e numrit të duhur të gjykatësve, numrin e madh të rasteve të grumbulluara, pagat e ulëta të gjykatësve dhe prokurorëve, paqartësia e një numri të ligjeve dhe konflikti në kompetenca dhe mekanizmat e dobët të mbikëqyrjes.

- Administrata ndërkombëtare dhe IPVQ duhet të promovojnë bashkëpunimin në mes të sektorëve të institucioneve të ndryshme të sigurisë dhe drejtësisë, t'i ofrojnë përkrahje shtesë prokurorëve dhe të përmirësojnë mekanizmat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

Informatat në lidhje me sektorin e sigurisë dhe drejtësisë nuk janë gjithnjë të arritshme apo të detajuara në mënyrë të mjaftueshme, dhe është vështirë për disa komunitete të minoriteteve të gjejnë informacion rreth sistemit të gjykatave të udhëhequra nga institucionet e Kosovës.

- IPVQ, mediat lokale dhe administrata ndërkombëtare kanë përgjegjësi të korrigojnë mungesën e informacioneve nga sektori i sigurisë dhe drejtësisë me shpërndarjen më të mirë të informatave në lidhje me rastet, përgjegjësitë, kompetencat dhe të drejtat e qytetarëve.

Qeverisja dhe politika

Ekziston një huti në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve të ndryshme, në veçanti me IPVQ dhe UNMIK, të cilat janë rritur nga transferimi gradual i kompetencave nga UNMIK në IPVQ dhe mungesën e transparencës në institucionet qeverisëse dhe në agjencitë. Kjo vështirëson llogaridhënien nga ana e përfaqësuesve të qeverisë dhe komuniteti ndërkombëtar mbetet i papërgjegjshëm ndaj popullsisë dhe institucioneve të Kosovës. Të gjitha këto na shpiejnë drejt një padrejtësie dhe cinizmi në mesin e popullit.

- Kompetencat specifike të IPVQ, UNMIK dhe misioni potencial i ardhshëm i Sigurisë Evropiane dhe Politikave të Mbrojtjes (ESDP) duhet t'i bëhen të qarta popullit të Kosovës.
- IPVQ duhet të përkrahët në marrjen e një roli më të madh në definimin e nevojave dhe praktikave në fushat ku ata kanë kompetenca të qarta.
- Donatorët të cilët sigurojnë një përkrahje të tillë duhet të koordinojnë përpjekjet e tyre dhe të sigurohen se intervenimet e tyre janë dizajnuar në bazë të nevojave specifike të Kosovës se sa të aplikojnë modele nga shtete të ndryshme të cilat përfundimisht mund të mos jenë të përshtatshme për Kosovën.

Ekzistenca e strukturave paralele mbetet një çështje kontradiktore. Aktualisht institucionet e financuara nga Beogradi veprojnë në komunitetet serbe në tërë Kosovën, duke siguruar shërbime publike dhe duke e ndarë politikën e serbëve të Kosovës dhe shërbimet sociale nga politika dhe shërbimet e Kosovës. Përderisa ata

ofrojnë një mbështetje kulturore dhe politike për ata të cilët dëshirojnë t'i mbajnë lidhjet me Beogradin, fakti se ato ekzistojnë ende dhe ndikimi ekonomik dhe politik që kanë, nga shumë njerëz janë konsideruar si shkaktar të konfliktit. Vendimi rreth të ardhmes së këtyre strukturave është i rëndësishëm për stabilitetin politik dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore, por është një çështje shumë e ndjeshme e cila ngërthen disa prej shkaktarëve të konfliktit lidhur me identitetin, të shprehura nga të intervistuarit dhe pjesëmarrësit e fokus grupeve.

- Vendimet mbi të ardhmen e strukturave paralele dhe shërbimeve të cilat ato ofrojnë duhet të bëhen transparente, konsultative dhe të merren parasysh ndikimet e mundshme sociale, ekonomike dhe politike.

Faktorët shoqëror dhe kulturor

Ekzistojnë shumë ndarje në shoqërinë e Kosovës, duke përfshirë ndarjen në rritje urbane-rurale, ndikimet e migrimeve brenda Kosovës, çështjet e mbetura rreth lirisë së lëvizjes dhe ndarjet etnike. Kjo e fundit është njëra prej ndarjeve kryesore në shoqërinë e Kosovës. Njerëzit janë pothuajse ekskluzivisht të definuar nga prejardhja etnike e tyre se sa identitetet tjera si profesioni, interesat, apo gjinia dhe ekzistojnë pak lidhje kulturore në mes të komuniteteve, sidomos në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe komuniteteve serbe në Kosovë. Ekziston një frustrim se përderisa njerëzit i njohin çështjet e ndarjes ndër-etnike, ka shumë pak diskutime në lidhje me aspektet e ndryshme të tensioneve ndër-etnike dhe se si të adresohen ato.

- Institucionet vendore dhe ndërkombëtare duhet të ndihmojnë në përafrimin e ndarjeve në mes të popullsisë rurale dhe urbane dhe të zhvillimeve të pabarabarta në mes të komuniteteve të ndryshme, duke siguruar se intervenimet e tyre nuk janë të synuara vetëm në komunitetet dhe komunën e Prishtinës.
- Institucionet vendore dhe ndërkombëtare duhet të përkrahin më shumë diskutimetë vazhdueshme dhe të përkushtuara në lidhje me çështjet 'ndër-etnike'.

Ekonomia dhe jetesa

Sfidat ekonomike të Kosovës janë rritur nga lufta 1998-99 dhe pasiguria e vazhdueshme në lidhje me statusin përfundimtar politik. Kjo ka kontribuar në papunësinë e madhe, e cila i rrit edhe më shumë frustrimet e popullsisë në lidhje me shtyerjen e zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës.

- Administrata ndërkombëtare dhe IPVQ-të duhet t'i adresojnë pritjet e larta të njerëzve mbi përfitimet ekonomike nga pavarësia e mundshme, derisa të qartësohet e ardhmja politike e Kosovës.

Paaftësia e qeverisë për t'i vënë taksë të gjitha burimeve të të ardhurave të saj, do të thotë se ka pak mundësi që të rishpërndahet pasuria te ata njerëz të cilët kanë më së shumti nevojë. Standardet e ulëta të jetesës janë të lidhura me pagat e ulëta të atyre të cilët janë të punësuar dhe çmimet e larta të artikujve themelor.

- Administrata ndërkombëtare dhe IPVQ-të duhet të përmirësojnë procesin e privatizimit, duke e bërë atë më transparent, të stimulojnë krijimin e punëve të reja dhe të asistojnë në rishpërndarjen e drejtë të pasurisë. Prodhimi vendor dhe investimet e huaja dhe vendore duhet të përkrahin të gjitha.

iv *Perceptimet e konfliktit, qasja në drejtësi dhe mundësitë për paqe në Kosovë*

Energjia elektrike gjithashtu perceptohet si një shkaktar i konfliktit. Reduktimet e planifikuara dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike në tërë Kosovën dhe vështirësitë e pagimit të faturave të energjisë elektrike shkaktojnë nervozizëm dhe frustrime, shpeshherë të drejtuara më shumë kundër komuniteteve tjera se sa drejt Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Shumë zona në Kosovën veriore furnizohen me energji elektrike relativisht mirë për shkak të përkrahjes së vazhdueshme nga Beogradi. Ekziston një rrezik se dallimet në furnizim me energji për komunitetet e ndryshme mund të kontribuojnë në keqësim të mëtutjeshëm të marrdhënieve në mes tyre.

- Administrata ndërkombëtare dhe IPVQ-të duhet seriozisht të merren me sigurimin e energjisë elektrike në tërë Kosovën në mënyrë transparente, sa më shpejtë që është e mundur.

Përfundim

Në kërkimin dhe evidentimin e shqetësimeve dhe perceptimeve, të një mostre të njerëzve nga komunitetet e Kosovës, në disa prej çështjeve të ndërlidhura me siguri, ky raport i identifikon shkaktarët potencial të konfliktit dhe sygjeron mundësi për paqe, të cilat lidhen direkt me nevojat dhe përvojat e komuniteteve të përfshira në hulumtim.

Që të dizajnohen intervenimet e sigurisë bazuar në nevoja dhe të fokusuar në njerëz, të cilat mbështeten në mundësitë për paqe dhe menjanimin e shkaktarëve të acaruar të konfliktit, komuniteti ndërkombëtar, agjencitëdonatore dhe IPVQ-të duhet të përpiqen që të përfshijnë komunitetet në një proces të sigurtë pjesëmarrës në identifikimin e lëmive prioritare për veprim. Me hulumtimin dhe analizimin e nevoja lokale dhe reflektimin e tyre në strategjitë e financimeve dhe hartimet e programeve, institucionet ndërkombëtare dhe lokalemund të punojnë në partneritet me komunitetet lokale drejt vendosjes së një paqeje të qëndrueshmenë Kosovë.

Përmbajtja

Akronimet	2
1 Hyrje	3
2 Statusi i ardhshëm i Kosovës	4
2.1 Statusi i ardhshëm (i pazgjidhur) i Kosovës si nxitës i konfliktit	4
2.2 Statusi i ardhshëm i Kosovës si mundësi për paqe	6
3 Siguria dhe drejtësia	7
3.1 Çështjet nga siguria dhe drejtësia si nxitës të konfliktit në Kosovë	7
3.2 FOKUS: Qasja në drejtësi	8
3.2.1 Mungesa e qartësisë dhe ndarja e paqartë e kompetencave	9
3.2.2 Mungesa e qartësisë së ligjeve	10
3.2.3 Qasja e dobët në informacione	12
3.2.4 Perceptimi për raportim të papërshtatshëm të mediave mbi krimin	13
3.2.5 Besimi i pabarabartë në ShPK-në	14
3.2.6 Kapaciteti i dobët dhe perceptimi për korrupsion në sistemin e drejtësisë	15
3.2.7 Qasja e vështirë në gjykata	16
3.2.8 Mungesa e mbrojtjes efektive të dëshmitarëve dhe viktimave	17
3.2.9 Dënimi dhe kaucioni	18
3.2.10 Mekanizmat jozyrtar të drejtësisë	18
3.3 Rekomandime për përmirësimin e qasjes në drejtësi	20
3.3.1 Konsolidimi i roleve dhe përgjegjësive në sektorin e drejtësisë	21
3.3.2 Sqarimi i bazës ligjore	22
3.3.3 Përmirësimi i qasjes në gjykata	22
3.3.4 Fuqizimi i rolit të mediave	23
3.3.5 Përmirësimi i besimit në ShPK	23
3.3.6 Adresimi i mungesës së kapaciteteve në sistemin gjyqësor	23
3.3.7 Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave të krimit	24
4 Qeverisja dhe politika	26
4.1 Qeverisja dhe politika si nxitës të konfliktit	26
4.2 Mundësitë për paqe në politikën dhe qeverisjen në Kosovë	27
5 Çështjet shoqërore dhe kulturore	28
5.1 Çështjet shoqërore dhe kulturore si nxitës të konfliktit në Kosovë	28
5.2 Mundësitë për paqe në sferat shoqërore dhe kulturore	30
6 Ekonomia dhe jetesa	32
6.1 Ekonomia dhe jetesa si nxitës të konfliktit në Kosovë	32
6.2 Mundësitë për paqe në sferën e ekonomisë	33
7 Përfundim	35
Aneksi A: Metodologjia	36

Akronimet

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
AVL	Armët e Vogla dhe të Lehta
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese
CBDC	Qendra për Zhvillimin e Komunitet dhe Biznesit
CBM	Community Building Mitrovica
CCSD	Centre for Civil Society Development
CSD	Communication for Social Development
EPBE	Ekipi Planifikues i Bashkimit Evropian
FIQ	Forumi për Iniciativa Qytetare
INPO	Iniciativa për Progres
IPVQ	Institucionet Vetëqeverisëse të Kosovës
KCIC	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rrjeti Rinor i Gjilan
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forca Mbrojtëse e Kosovës
KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
NSh	Ndërmarrje Shoqërore
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PESM	Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje
PHRC	Peace and Human Rights Council
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së
PZhBV	Person i Zhvendosur Brenda Vëndit
RKSKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
RTK	Radiotelevizioni i Kosovës
SiV	Syri i Vizionit
ShPK	Shërbimi Policor i Kosovës
TMK	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZNC	Zyra Ndërkombëtare Civile

1 Hyrje

Kosova gjendet në një udhëkryq. Faktorët kryesor që aktualisht mbajnë territorin në një gjendje të “konfliktit të ngrirë”, përfshirë edhe vendimet thelbësore mbi statusin e ardhshëm, duhen adresuar në mënyrë që Kosovën ta shpiejn drejt një të ardhme më prosperuese dhe të qëndrueshme. Pas më shumë se tetë viteve të administrimit ndërkombëtar dhe përpjekjeve qëllim-mira të krijimit të paqes nga donatorët dhe agjencitë ndërkombëtare, ende mbetet shumë për t’u bërë për të siguruar paqen dhe stabilitetin e ardhshëm të Kosovës. Sidoqoftë, një shoqëri me besim dhe informim në rritje e sipër, një dëshirë e përbashkët për të dalë nga ngecja ekonomike e pas-luftës dhe aftësitë dhe dijenia e popullsisë së Kosovës, të gjitha sjellin mundësi të mira për krijimin e një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme.

Ky raport, i bazuar në një metodologji gjithëpërfshirëse të analizës së konfliktit³, është kulmi i hulumtimit, këshillimit dhe sygjërimeve nga organizatat e shoqërisë civile në tërë Kosovën. Fillimisht i konsideruar si hulumtim i fokusuar në problemet specifike të lidhura me qasjen në drejtësi në Kosovë, entuziazmi dhe idetë e njëmbëdhjetë organizatave të përfshira kanë krijuar një punë më ambicioze. Hulumtuar në mes të muajit shtator dhe tetor 2007, janë mbajtur njëmbëdhjetë seminare për të identifikuar nxitësit e konfliktit në tërë Kosovën dhe nivelet rajonale dhe kanë përfshirë pjesëmarrës nga të gjitha rajonet e Kosovës. Janë mbajtur edhe gjashtëmbëdhjetë fokus grupe të organizuara dhe të drejtuara nga organizata joqeveritare rajonale (OJQ) dhe kanë përfshirë pjesëtarë nga komuniteti shqiptar, boshnjak, ashkali, goran, rom, serb dhe turk në Kosovë në të cilat u shqyrtuan çështjet në lidhje me qasjen e gjerë në drejtësi, përfshirë edhe mekanizmat zyrtar dhe ata jozyrtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

OJQ-të gjithashtu intervistuan rreth shtatëdhjetë njerëz të përfshirë, në njëfarë mënyre, në sektorin e drejtësisë – prokurorë, policë, gjykatës, zyrtar gjyqësor, përfaqësues të zyrës së Ombudspersonit, kryetar komunash dhe përfaqësues tjerë komunash, avokat, përfaqësues të OJQ-ve të specializuara dhe gazetarë. Një pjesë e madhe e procesit është përcjellur nga përfaqësues të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK) dhe Dept/Diviz Ministrisë së Punëve të Brendshme të Institucioneve Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ).

Informacioni dhe analizat e diskutuara në raport vijnë nga seminarët, diskutimet në fokus grupe dhe intervistat, si dhe hulumtimet e bëra nga Saferworld dhe Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ). Si rrjedhojë, ky raport reflekton perceptimet e publikut të Kosovës dhe punëtorëve të sektorit të drejtësisë e jo perceptimet e Saferworld, FIQ-it, OJQ-ve tjera të përfshira në hulumtim, ose donatorëve të tyre.

Edhe pse u bë çdo përpjekje për të inkurajuar pjesëmarrjen e një numri të madh të meshkujve dhe femrave nga rajone dhe etnitete të ndryshme, raporti përfundimtar është një reflektim i pjesshëm i pikëpamjeve të komuniteteve të Kosovës dhe nuk jep një pasqyrë të plotë. Kuotimet e cekura në kutitë me tekst në raport janë mendime të disa të intervistuarve, por nuk janë domosdo të aprovuara nga autorët.

³ Shih Aneksin: Metodologjia për përshkrimin e detajizuar të definicioneve dhe metodologjisë së përdorur.

‘Statusi përfundimtar’ është i përhapur në shqetësimet e njerëzve në këtë raport. Ai lidhet me të gjitha sferat e jetës në Kosovë – shoqërore, ekonomike, kulturore, politike dhe të sigurisë. Njerëzit janë arsyeshem të shqetësuar mbi atë se si do të ndikoj në jetën e tyre zgjidhja e statusit, si dhe janë të frustruar që shtyrjet e zgjidhjes po i pengojnë përpjekjet për përmirësimin e situatës në Kosovë. Por, për më tepër ata ndihen të izoluar nga negociatat, të pafuqishëm për të ndikuar në ndodhitë politike, dhe të painformuar ndaj arsyeve prapa vendimeve, si dhe kështu janë shumë pesimist mbi atë se ata nuk mund të bëjnë asgjë që të marrin kontrollin për fatin e tyre. Adresimi i kësaj heqje të së drejtës – pavarësisht se çfarë ndodh më 10 dhjetor 2007 ose pas, kur treshja ndërkombëtare do të raportoj mbi rezultatet e bisedimeve të fundit në mes Prishtinës dhe Beogradit – do të jetë vendimtare të sigurohet paqja dhe stabiliteti në të ardhmen në Kosovë.

Ky raport u hulumtua gjatë kohës së fushatës zgjedhore kur shoqëria civile ishte jashtëzakonisht shumë e përfshirë në rolin e saj mbikëqyrës, dhe në një kohë të tensionit kur OJQ-të përgjatë Kosovës janë shpesh duke punuar, përkundër mundësive të vogla, që të krijojnë paqe në rajonin e tyre. Angazhimi dhe ndryshimi i këtyre organizatave ka qenë shumë i vlefshëm në krijimin e raportit i cili, shpresojmë, reflekton mprehtësinë dhe kompleksitetet e opinionit, si dhe ndihmon në identifikimin e nxitësve kyç të konfliktit dhe fushave kyçe për krijimin e paqes në Kosovë. Por, shpresojmë që do të jetë më shumë se kaq. Shpresojmë se nuk do të jetë “edhe një raport të cilin askush nuk do ta lexojë⁴”, por një kontribut në fillimin e procesit të dëgjimit të zërave të komuniteteve të ndryshme, një kontribut në rritjen e respektit të dyanshëm në mes zyrtarëve vendor dhe ndërkombëtar dhe njerëzve të Kosovës, pastaj i krijimit dhe implementimit të reformave që adresojnë nxitësit e konfliktit dhe krijojnë mundësi të shumta sot për paqe në Kosovë.

Ky raport ka për qëllim të analizoj dhe krijoj lidhje në mes nxitësve të mundshëm të konfliktit në Kosovë, duke i grupuar kështu në pesë kategori kryesore: statusi i ardhshëm i Kosovës; siguria dhe drejtësia; politika dhe qeverisja; shoqëria dhe kultura; dhe ekonomia dhe jetesa. Secila kategori përmbledh pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në seminarët e mbajtura për identifikimin e nxitësve të konfliktit, nga fokus grupet dhe intervistat kyçe informative mbi secilën temë, si dhe sugjeron mundësi për krijimin e paqes të lidhur me temën. Raporti përfundon me disa rekomandime për hapat e ardhshëm që duhen konsideruar nga politikëbërësit ndërkombëtar dhe vendor të politikave dhe agjencitë implementuese.

2 Statusi i ardhshëm i Kosovës

2.1 Statusi i ardhshëm (i pazgjidhur) i Kosovës si nxitës i konfliktit

Statusi i ardhshëm i Kosovës është i përhapur në të gjitha aspektet e jetës politike në Kosovë për të gjitha komunitetet, dhe gjithashtu politizon shumë aspekte tjera të jetës. Statusi perceptohet si nxitësi primar i konfliktit nga shumë njerëz, për shkak të pasigurisë se çfarë do të ndodhë dhe për shkak të lidhjes me shumë çështje tjera. Kjo çështje është ndarësi kryesor në mes popullsisë shqiptare dhe serbe të

⁴ Pjesëmarrës në fokus grup në Graçanicë

Kosovës, ku secili grup ka pikëpamje të kundërta mbi 'pavarësinë'. Dhe, edhe pse vendimet mbi statusin përfundimtar janë të lidhura me nxitjen e konfliktit në nivele të ndryshme, gjithashtu është e qartë se shtyrjet e vazhdueshme të vendimit mbi statusin përfundimtar mund të çojnë drejt dhunës dhe jostabilitetit.

Në të gjitha seminarët e mbajtura për identifikimin e nxitësve të konfliktit (rajonale dhe në mbarë Kosovën), ndryshimet mbi temën e statusit përfundimtar u dalluan si një nga tre nxitësit kryesorë të konfliktit. Shumica e njerëzve janë të shqetësuar se shtyrja e vazhdueshme në bisedimet mbi statusin e ardhshëm të Kosovës është duke shkaktuar frustrim që mund të shpie drejt demonstratave dhe konfliktit të dhunshëm, por për disa (sidomos serbët e Kosovës në komunat veriore), pasiguria për status quo-në është më preferueshme se sa mundësia e një Kosove të pavarur dhe pasojat që do të shkaktoheshin. Pasiguria aktuale u rrit shpresën se pavarësia nuk do të ndodhë, si dhe heq motivet për ata që të angazhohen në strukturat e Kosovës. Të gjithë pajtohen se vendimi mbi statusin përfundimtar, kur të ndodh, do të shkaktoj një nivel të konfliktit. Nëse Kosova merr një formë të pavarësisë, disa komunitete minoritare janë të shqetësuara se mund të vuajnë nën qeverisjen e 'shumicës shqiptare'. Por, nëse Kosova nuk merr pavarësinë, atëherë shumica e pjesëmarrësve në seminare për identifikimin e nxitësve të konfliktit janë të bindur se frustrimi në mesin e shqiptarëve të Kosovës mund të përfundoj me dhunë, dhe shumë nxitës të tjerë të konfliktit nuk do të adresohen (si ndarja e paqartë e kompetencave të strukturave qeveritare dhe nivelit të dobët të zhvillimit ekonomik).

Nevoja e perceptuar për unitet për secilën 'palë' është duke e penguar debatin dhe në të njëjtën kohë është duke dekurajuar kritikën ndaj politikave të IPVQ-ve dhe Beogradit, duke bërë kështu mbikëqyrjen e bërjes së politikave gati të pamundur dhe duke parandaluar zhvillimin e marrëdhënieve ndëretnike të cilat mund të kenë efekte afatgjata të pajtimit. Në të njëjtën kohë, njerëzit shpesh janë të habitur me atë se çfarë del prej procesit të bisedimeve dhe si të interpretojnë propozimet e ndryshme (si Propozimin e Ahtisaarit⁵) që vijnë nga zhvillimi i bisedimeve. Njerëzit (nga të gjitha komunitetet) ndihen të lënë anash nga bisedimet e udhëhequra nga niveli i lartë ndërkombëtar, të privuar nga e drejta e tyre dhe të pashpresë për të ndikuar në vendimet e marra në Uashington, Moskë, Bruksel dhe Nju Jork⁶.

Pasiguria mbi statusin e ardhshëm, dhe vendimin mbi të, lidhet me të gjitha çështjet e përshkuara në pjesën tjetër të këtij raporti. Për shembull, shumë njerëz besojnë se zgjidhja e statusit (në veçanti një Kosovë e pavarur) do të rezultojë në përmirësime të situatës ekonomike pasi që institucionet financiare ndërkombëtare do të lejohen që të ndihmojnë Kosovën ligjërisht më shumë se që janë duke bërë tani, dhe në një klimë më të sigurtë për investime të huaja direkte. Kjo lidhet ngushtë me nivelin e lartë të papunësisë si njëri nga shqetësimet kryesore të sigurisë: shumë mendojnë se kjo do të 'zgjidhet' me rastin e marrjes së pavarësisë për Kosovën. Do të jetë thelbësore të menaxhohen pritjet publike në lidhje me zgjidhjen e statusit të Kosovës, sepse nuk do të rezultojë në zbutjen e menjëhershme të problemeve ekonomike.

⁵ Martti Ahtisaari, i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, paraqiti propozimin e tij gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës në Kombet e Bashkuara me 2 Shkurt 2007. Propozimi mund të gjendet në adresën <http://www.unosek.org/unosek/en/statusproposal.html> (qasur së fundi me 17 Nëntor 2007).

⁶ Ndoshta si rezultat i kësaj, shumë nga njerëzit e përfshirë në këtë hulumtim ishin të dyshimtë mbi rolin e zyrave të ndryshme ndërlidhëse (zyrave të shteteve të huaja në Kosovë) dhe disa i përmendën këto si nxitës të konfliktit, sipas të cilëve ekzistojnë thashetheme mbi spiunim dhe shantazh.

Poashtu, marrëdhëniet në mes kompetencave dhe ligjeve të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve shkaktojnë huti, gjë që shumë njerëz pretendojnë se do të zgjidhen me statusin e ardhshëm. Sidoqoftë, shumë paqartësi mbi kompetencat dhe bazat ligjore do të mbesin ende, pavarësisht nga statusi i ardhshëm, duke marrë parasysh historinë ligjore komplekse të Kosovës dhe përfshirjen ndërkombëtare të mbetur në territor, dhe kjo do të ndryshoj vetëm nëse bëhen më shumë përpjekje për të sqaruar situatën. Kjo huti i lejon autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që t'u shmangen përgjegjësive për veprimet e tyre. Sidoqoftë, linjat e llogaridhënies dhe mekanizmat për mbikëqyrje janë të dobët, por ato janë dobësuar më shumë nga mundësia aktuale e vënies së fajit tek autoriteti tjetër për jokompetencë, neglizhencë ose vendime jo të mira.

Sipas fokus grupeve dhe të intervistuarve, në aspektin shoqëror, pasiguria mbi statusin është duke i dëmtuar përpjekjet nga disa për të përafruar ndarjet ndëretnike, dhe është duke i politizuar marrëdhëniet funksionale dhe dekurajuar kompromisin. Gjithashtu, kjo është duke u përdorur si arsytim nga politikanët për problemet e vazhdueshme me shqetësimet shoqërore, si furnizimi me energji elektrike, shërbimet shëndetësore, varfëria dhe papunësia. Në Kosovën e pas-statusit, këto çështje mund të bëhen më të dukshme dhe pakënaqësia me veprimet politike për t'u marrë me këto probleme mund të jetë një nxitës i ri i konfliktit.

2.2 Statusi i ardhshëm i Kosovës si mundësi për paqe

Pasiguria e vazhdueshme mbi statusin e ardhshëm të Kosovës e bënë popullin e Kosovës të ndjehet i frustruar dhe i pashpresë në adresimin e këtyre çështjeve që kanë ndikim në jetën e tyre – 'gjithçka është e lidhur me statusin përfundimtar' është një frazë, e cila është përdorur gati në secilin seminar gjatë këtij procesi. Por, ekzistojnë gjëra të cilat mund të bëhen në nivelet 'nën' procesin ndërkombëtar të bisedimeve mbi statusin e ardhshëm, si adresimi i disa çështjeve specifike (disa nga të cilat janë përmendur në pjesën tjetër të këtij raporti). Ekzistojnë gjithashtu edhe disa aktivitete që mund të ndihmojnë në uljen e shqetësimit mbi statusin e ardhshëm dhe ndoshta mund të inkurajojnë parashikimin se si mund të duket shoqëria e pas-statusit (sidomos për komunitetet minoritare).

Një nga çështjet kyçe në këtë aspekt është nevoja për **të ofruar më shumë informacione mbi procesin e statusit të ardhshëm dhe implikimet e propozimeve të ndryshme për jetën e përditshme të njerëzve**. Komuniteti ndërkombëtar dhe IPVQ-të kanë mundësi të veçanta për t'i komunikuar veprimet e tyre (dhe arsyet për këto veprime) në një mënyrë më të qartë dhe transparente. Ofrimi i më shumë mundësive që njerëzit të përfshihen në debate të hapura për këto çështje të ndjeshme me vepruesit janë të përfshirë drtejtpërdrejtë në bisedime do të ishte një hap pozitiv në uljen e frikës nga e panjohura, si dhe do të ulte paqartësinë në lidhje me bisedimet mbi statusin e ardhshëm.

Zyrat Ndërlidhëse, e sidomos ato që përceptohen si veçanërisht me ndikim të madh në negociata (zyra e ShBA-ve, britanike, franceze, gjermane dhe ruse) duhen konsideruar mbajtjen e debateve dhe seancave me pyetje dhe përgjigje në komunitetet në tërë Kosovën, duke i adresuar kështu arsyet për pozicionet e tyre politike, dhe duke u përgjigjur pyetjeve mbi qëllimet e tyre të sakta politike. Hutia më e madhe ekziston jashtë kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, kështu që do të ishte e rëndësishme që të udhëtohej në komunat tjera për këtë dialog. Në një klimë ku mosbesimi në UNMIK është duke u rritur në të gjitha komunitetet e Kosovës,

Bashkimi Evropian (i pranishëm si Ekipi Planifikues i BE-së dhe Zyra Ndërkombëtare Civile) tashmë ka bërë disa përpjekje për t'iu qasur komuniteteve, por përpjekjet e tyre nuk janë të mjaftueshme dhe deri më sot kanë qenë më tepër një-drejtimëshe. Tani është mundësia për të bërë pyetje – dhe për të marrë përgjigje – dhe për dialogun pasues i cili u mungon njerëzve të Kosovës.

Kuptohet që në këtë çështje **IPVQ-ve** u takon që të luajnë një rol më të rëndësishëm, por këtu duhen përfshirë edhe më shumë detaje mbi politikën e tyre për Kosovën, e veçanërisht politikën kundërthënëse si decentralizimi. IPVQ-të duhen në veçanti t'i qasen minoriteteve etnike, femrave dhe popullsisë rurale, duke përfunduar kështu porosinë që IPVQ-të janë aty për t'i shërbyer popullit të Kosovës – edhe pse kjo porosi fillimisht mund të refuzohet në disa komunitete më të izoluar. Debatet në komunitet dhe seminarët informative janë të dobishme, jo vetëm për ofrimin e informacioneve, por gjithashtu i japin mundësi komuniteteve që t'i shprehin mendimet e tyre. Këto ndodhi gjithashtu mund të jenë mundësi për ndarjen e tregimeve të komuniteteve shumëetnike, të cilat kanë gjetur mënyra për të jetuar bashkë. Në komunitetet më të izoluar, këto ndodhi duhen trajtuar me kujdes dhe mund të kërkojnë qasje hap-pas-hapi në mënyrë që të mos rrezikohet politizimi i përpjekjeve për informim qytetar deri në atë masë sa të bëjnë më shumë dëm se mirë.

Shoqëria civile, në veçanti organizatat joqeveritare dhe mediat, janë një urë kyçe mes institucioneve dhe komuniteteve, të cilat mund të këshillojnë institucionet mbi përmbajtjen dhe praktikën e debateve dhe të cilat mund të ndihmojnë në bashkëveprimin me komunitete, si dhe në përcjelljen e porosive të komuniteteve. Shumë organizata të shoqërisë civile dëshirojnë të ndihmojnë në përmirësimin e kualitetit të informacioneve dhe në debatet mbi çështjet e statusit të ardhshëm, por shpesh ato trajtohen me respekt të pamjaftueshëm nga autoritetet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

3 Siguria dhe drejtësia

3.1 Çështjet nga siguria dhe drejtësia si nxitës të konfliktit në Kosovë

Sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve, të intervistuarve dhe gjetjeve nga seminarët për identifikimin e nxitësve të konfliktit, sundimi i dobët i ligjit dhe ndjenjat e lidhura me pasigurinë janë nxitësit kryesorë të konfliktit në Kosovë. Dobësia e sektorit të drejtësisë nënkupton që njerëzit nuk mund t'i adresojnë ankesat e tyre nëpërmjet sistemit gjyqësor dhe si pasojë “marrin drejtësinë në duart e tyre”. Shumë njerëz mbajnë armë, sepse ndihen të pasigurt dhe të pambrojtur (dhe të frikësuar nga një konflikt i ardhshëm), dhe mund t'i përdorin ato për shkak se ligji nuk funksionon⁷. Kjo nënkupton që mosmarrëveshjet relativisht të vogla mund të kalojnë shpejtë në konfrontime të dhunshme. Protestat legjitime demokratike gjithashtu mund të dalin jashtë kontrollit, dhe kështu përgjigjet ndaj këtyre protestave nga garantuesit e sigurisë duhet të jenë mirë të menduara. Reagimet apo përgjigjet e rënda (si ato të

⁷ Për detaje të mëtejshme të numrit të përafërt të armëve në pronësi civile dhe përcëptimin publik të sigurisë shih AVL *Hulumtimi në Kosovë* (2006), Saferworld/SEESAC

Krimet nga e kaluara

Derisa nuk u konsiderua si një nga nxitësit kryesor të konfliktit në mesin e komunitetit të shumicës shqiptare, serbët e Kosovës përmendën dështimin e vendosjes së drejtësisë për krimet e kryera menjëherë pas luftës së viteve 1998-99 dhe trazirat e marsit si "një nga pengesat më të mëdha në zhvillimin e dialogut dhe pajtimit të sinqertë ndëretnik". Kjo lidhet me mosbesimin e vazhdueshëm të serbëve të Kosovës në sistemin gjyqësor të drejtuar nga qeveria e Kosovës. Sidoqoftë, të intervistuarit kryesisht fajësojnë UNMIK-un e jo institucionet e Kosovës për dështimin që të shërbej si ndërmjetës në mes komuniteteve.

10 shkurtit 2007⁸) mund të kenë shtrirje më të madhe se vetë protestat, por dështimi për të reaguar shpejtë (si me 17 mars 2004⁹) gjithashtu nënkupton që një protestë mund të dalë jashtë kontrollit dhe kthehet në trazirë. Veç kësaj, përkundër përmirësimeve të vazhdueshme në reagimin e policisë ndaj protestave, shumë njerëz (sidomos në Mitrovicë) janë të shqetësuar se KFOR-i dhe ShPK-ja nuk do të reagojnë mjaft shpejtë në të ardhmen.

Në këtë periudhë të tensioneve të ngritura, prania e dukshme e grupeve të armatosura mund të shkaktoj konflikt dhe në mënyrë të natyrshme mund të rris ndjenjat e pasigurisë. Në Mitrovicën jugore dhe në Gjakovë, ekziston një shqetësim mbi disa grupe të cilat janë rishfaqur kohëve të fundit, respektivisht Armata Kombëtare Shqiptare (AKSh), Garda e Car Llazarit, dhe Rojet e Urës. Derisa këto grupe vetvetiu nuk janë shkaktarë strukturor të konfliktit në Kosovë, prania e tyre kontribuon në ndjenjat e tensionit dhe e bënë më të mundshme që një situatë tashmë e tensionuar të bëhet e dhunshme.

Njerëzit gjithashtu shprehën shqetësimet mbi grupet kriminale (shpesh të armatosura), sidomos në rajonet kufitare si Gjilani dhe Prizreni, ku kontrabanda është ngritur si çështje shqetësuese. Në kohën e hulumtimit dhe shkrimit të këtij raporti, Kosova ishte në mes të një fushate zgjedhore. Ndarjet në mes partive politike dhe vetë procesi zgjedhor në disa raste gjatë këtij hulumtimi u identifikuan si burime të mundshme të tensionit dhe nxitës të konfliktit. Përgjigjet mbi këtë çështje treguan se të intervistuarit shpesh lidhën krimin e organizuar dhe pasigurinë me partitë politike dhe politikanët. Retorika e politikanëve gjithashtu u konsiderua si nxitës i mundshëm i konfliktit për shumë pjesëmarrës, pasi që mund të ketë ndikim në frikën e njerëzve, fuqizimin e stereotipeve dhe në ndarjen e mëtutjeshme të komuniteteve.

3.2 FOKUS: Qasja në drejtësi

Qasja e dobët në drejtësi u identifikua si një ndër shkaktarët kryesor të konfliktit në Kosovë në një analizë të mëparshme të udhëhequr nga Saferworld dhe FIQ në periudhën shkurt-mars 2007¹⁰. Pamundësia për t'iu qasur institucioneve të drejtësisë

⁸ Me 10 Shkurt 2007, një demonstratë paqësore nga lëvizja Vetëvendosje në Prishtinë u kthye në të dhunshme, duke rezultuar me vdekjen e dy protestuesve pasi që Policët Rumun të UNMIK-ut gjuajtën turmën me plumba gome.

⁹ Me 17 Mars 2004, shpërthyen trazirat të cilat zgjatën tri ditë, dhe të cilat u shtrinë në tërë Kosovën dhe rezultuan me vdekjen e së paku nëntëmbëdhjetë njerëzve. Reagimi i garantuesve vendor dhe ndërkombëtar të sigorisë u kritikua si i ngadalshëm dhe i papërshtatshëm.

¹⁰ Siguria njerëzore në Kosovë: Analizë e konfliktit (Prill 2007), SafePlace, e papublikuar

(për arsyen se ato janë shumë të dobëta, të pakta, të korruptuara ose të përceptuara si të padrejta) mund të çoj drejt konfliktit pasi që njerëzit mendojnë se “ata duhet të marrin ligjin në duart e tyre” për të mbrojtur familjet e tyre dhe t'i korrigjojnë gabimet që mendojnë se u janë bërë. Aty ku armët posedohen më së shumti, kjo do të thotë

“Ata (prokurorët) e kryejnë punën e tyre mirë, duke pas parasysh vështirësitë që i hasin. Jemi pjesërisht të kënaqur me punën e tyre” – Polic i ShPK-së

se grindjet mund të rriten shpejt, dhe aty ku mekanizmat jozyrtar të drejtësisë përdoren shumë, grupet e ndjeshme mund të marginalizohen nga procesi i drejtësisë. Si pasojë, ky hulumentim u përqëndrua në probleme të veçanta duke

iu qasur mekanizmave të drejtësisë në Kosovë me synimin për të dhënë këshilla praktike se si duhet përmirësuar qasja në drejtësi për të gjithë.

Informatat dhe analizat mëposhtë burojnë nga puna e OJQ-ve regjionale në diskutimet e fokus grupeve, intervistat me zyrtarët e sektorëve të drejtësisë, si dhe nga disa hulumtime nga Saferworld dhe FIQ. E gjithë kjo mund të shihet si diçka që reflekton vetëm perceptimet e publikut të Kosovës dhe një shembull të punonjësve të drejtësisë.

“Kemi bashkëpunim të ngushtë me ShPK-në” – Prokuror publik

3.2.1 Mungesa e qartësisë dhe ndarja e paqartë e kompetencave

Një nga problemet më të mëdha në sistemin e drejtësisë në Kosovë është ndarja e paqartë e kompetencave në mes të akterëve të ndryshëm. Kosova është e administruar nga UNMIK-u, por kompetencat janë duke iu bartur gradualisht IPVQ-ve. Ky proces i tranzicionit do të thotë se disa nga akterët nuk e kanë të qartë mandatin e tyre të saktë, nëse UNMIK-u ose IPVQ-të janë përgjegjës për bërjen e politikave dhe nxjerrjen e ligjeve në sektorin e drejtësisë, nëse gjykatësit e Kosovës apo ata ndërkombëtarë janë përgjegjës për disa raste dhe cilat ligje aplikohen.

Në përgjithësi, marrëdhëniet në mes të ShPK-së, prokurorëve dhe gjykatave mund të përmirësohen më shumë. Një gazetar komentoi se “ky trekëndësh shpeshherë keqpërdoret nga njëri ose tjetri. Për shembull, kur polici kryen detyrën e tij, prokurori mund ta vonojë punën ose kur prokurori e kryen detyrën, gjykata e vonon atë.” Mungesa e sqarimit të kompetencave dhe komunikimi i dobët lejon shumë akterë që të kalojnë fajin tjetërkund për parregullsitë e tyre.

Me 4 prill 2004, përgjegjësia për disa aspekte të hetimit u transferua nga ShPK-ja tek prokurorët, por si duket pati shumë pak trajnim për prokurorët se si të kryejnë hetimet¹¹, ndërsa linjat e komunikimit në mes policëve të ShPK-së dhe prokurorëve janë shpesh të paqarta. Në disa komuna, të dy palët, ShPK-ja dhe prokurorët thonë se kanë pasur bashkëpunim të mirë të ndërsjellë, por intervistat në shumë komuna tjera treguan se ky bashkëpunim është një ndër problemet më të mëdha në zinxhirin e drejtësisë.

¹¹ Shih Nuk është në Agjendë: Dështimi i vazhdueshëm për adresimin e përgjegjësisë në Kosovën e pas Marsit 2004 (Maj 2006), Human Rights Watch, f 28-31, mund të gjendet në adresën <http://hrw.org/reports/2006/kosovo0506/kosovo0506web.pdf>, qasur së fundi me 9 Nëntor 2007

Të gjithë prokurorët që u intervistuan thanë se bashkëpunimi me ShPK-në ishte “mirë” ose “përgjithësisht i mirë”. Sidoqoftë, shumë policë të intervistuar të ShPK-së nuk kishin vlerësime aq pozitive, pasi që mendonin se prokurorët mund të ishin më profesional, pastaj se prokurorët nuk komunikojnë me ShPK-në sa duhet dhe se ata jo gjithmonë i ndjekin hetimet e ndërmarra nga ShPK-ja. Nga ana tjetër, disa prokurorë u ankuan se cilësia e provave që ShPK-ja u dorëzon është e dobët, ku disa theksuan se kjo ka të bëjë me trajnimet dhe burimet e ShPK-së.

Përfaqësuesit e mediave dhe OJQ-ve të intervistuar kishin vlerësime më negative lidhur me bashkëpunimin ndërmjet ShPK-së dhe prokurorëve. Disa fajësuan ndikimin e politikës në institucione të ndryshme, ndërsa të tjerët thanë se prokurorët “japin përshtypje se ka bashkëpunim në mes tyre”, por realiteti është ndryshe. Sidoqoftë, ekzistojnë disa fakte se kjo situatë është duke u përmirësuar. Një përfaqësues i një OJQ-je nga Prishtina tha: “Unë kam përshtypjen se procedura e hetimeve në mes të policit dhe prokurorit është duke u bërë më efikase”.

“Ne kemi një kompilim të ligjeve të ish-Jugosllavisë, nga koha e Millosheviqit, rregulloreve të UNMIK-ut, Konventave Ndërkombëtare, ligjeve të reja të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës,” – Përfaqësues i Ombudspersonit

Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet gjykatave dhe prokurorëve shpesh është i

“Marrëdhënia ShPK-Zyrë e Prokurorit nuk është shumë e kënaqshme. Jemi 80 përqind të kënaqur me këtë bashkëpunim” – Zyrtar i Lartë i ShPK-së

dobët, edhe pse dallon nga komuna në komunë. Në Ferizaj, një gazetar pohoi se “ka mungesë bashkëpunimi ndërmjet Gjykatës Komunale dhe zyrës së Prokurorisë Publike. Zyra e Prokurorisë Publike deklaroi se ata i procedojnë

rastet rregullisht, por paditë përfundojnë në sirtarët e gjykatës, dhe atje mbesin për një kohë të gjatë dhe ndonjëherë edhe harrohen fare. Prandaj është normale që gjithë kjo krijon tension dhe i irriton qytetarët”.

Bashkëpunimi ndërmjet ShPK-së dhe gjykatave, veçanërisht për kundërvajtje të lehta të cilat nuk shkojnë nëpërmes zyres së prokurorit dhe përcjellja policore e të pandehurve për në gjykatë dhe nga gjykatat gjithashtu mund të përmirësohen. Disa gjykatës u ankuan se ndonjëherë rastet rrezikohen me zbulimin e informatave konfidenciale nga ShPK-ja.

3.2.2 Mungesa e qartësisë së ligjeve

Mungesa e një baze të vetme ligjore në Kosovë është duke shkaktuar paqartësi në mes të institucioneve dhe qytetarëve¹². Jo vetëm që është e vështirë për qytetarët të

kuptojnë se çfarë është e paligjshme dhe çfarë është e ligjshme, por është e vështirë edhe për institucionet e

“Ka raste kur qytetarët gjobiten nga policia dhe kur ky rast dërgohet në gjykatë ai anulohet, dhe kjo jep përshtypjen se nuk ka bashkëpunim të mirë në mes të [ShPK-së dhe gjykatës]” – Përfaqësues i një OJQ-je, Pejë

drejtësisë që të shpjegojnë bazat ligjore të cilat i zbatojnë. Në të njëjtën kohë, gjykatësit ndërkombëtar nga vende me sisteme të ndryshme ligjore e bëjnë edhe më

¹² Shih Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë (12 Dhjetor 1999) për më shumë detaje, që mund të gjendet në adresën: <http://www.unmikonline.org/regulations/1999/reg24-99.htm> (qasur së fundi me 16 nëntor 2007)

konfuz interpretimin e një ligji ose një rregulle në ndonjë rast. Për më tepër, kjo paqartësi e bën më të vështirë për mjetet e komunikimit të raportojnë me saktësi dhe organizatat e shoqërisë civile t'i mbajnë përgjegjëse këto institucione, sepse nuk është e qartë se cilat ligje ose standarde këto institucione i mbështesin.

"Situatë e paqartë": sistemet paralele të drejtësisë

Komuniteti serb në tërë Kosovën, veçanërisht në komunat veriore me shumicë serbe siç janë Zubin Potoku, Leposaviqi dhe Zveçani po ashtu edhe Mitrovica e veriut përdorin sisteme paralele të drejtësisë të administruara dhe të financuara nga Beogradi, si dhe ligjet e Serbisë (ndonjëherë edhe nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së por asnjëherë ligjet e Kuvendit të Kosovës). Komuniteti serb në Kosovë do t'i përdorë gati çdoherë këto sisteme paralele, por ka raste kur ju duhet të përdorin edhe sistemin e menaxhuar të Kosovës. E gjithë kjo krijon huti, vështirësi për qasje dhe bashkëpunim në mes dy sistemeve, dhe një fushë ku institucionet nuk janë përgjegjës ndaj njerëzve që i përfaqësojnë.

Në këtë kohë, kur bisedimet për statusin përfundimtar vazhdojnë dhe tensioni politik është i lartë, ka presion të madh në komunitetin serb të Kosovës që të përdorin sistemin e gjykatave të administruara nga Beogradi, por siç tha një pjesëmarrës i komunitetit serb në fokus grup, "gjykatësit, prokurorët dhe avokatët mbrojtës të ofruar nga shteti nuk janë aspak transparent dhe kjo ka të bëjë me faktin se ata janë duke punuar në një *status quo* dhe se ata nuk janë duke u mbikëqyrur nga askush e madje as nga ministrinë relevante të Beogradit."

Prania e dy sistemeve të drejtësisë krijon huti në popull duke mos ditur se cilave gjykata mund t'u drejtohen. Për shembull, personat e zhvendosur brenda vendit që jetojnë në Kosovën veriore nuk dinë se si t'i zgjidhin mosmarrëveshjet ndërmjet tyre lidhur me pronat, pasi që derisa ata nuk i pranojnë gjykatat e menaxhuara nga Kosova (nga një perspektivë politike), ata e kuptojnë se ndoshta duhet ta përdorin këtë sistem për të zgjidhur problemet e tyre. Në fakt, siç tha një pjesëmarrës në fokus grup në Mitrovicën e veriut, duket se "qeveria e Serbisë është duke pranuar juridiksionin e gjykatave të menaxhuara të Kosovës për rastet e mosmarrëveshjeve rreth pronave, por duket se ata nuk e pranojnë haptas për arsye politike, duke lënë një numër të anëtarëve të komunitetit serb të hutuar dhe të çorientuar kur bëhet fjalë për paraqitjen e rasteve të tyre në gjykatat e menaxhuara nga Kosova. A do të mund të gjykoheshin nga ndonjë anëtar i komunitetit të tyre? A do të shiheshin nga ekstremistët politik si tradhëtar të vendit?"

Disa të intervistuar me përvojë pune brenda strukturave paralele ndiheshin të pashpresë dhe të paafte për të përmirësuar sigurinë në komunitetet e tyre: "Ne (institucionet e administruara nga Beogradi) nuk mund të ndikojmë në asnjë çështje të sigurisë..... Ne vetëm i japim përkrahje morale popullit dhe kjo nuk është e mjaftueshme".

* - pjesëmarrës në fokus grup, Mitrovica veriore

3.2.3 Qasja e dobët në informacione

Në pjesën më të madhe të rajoneve të Kosovës, gazetarët dhe OJQ-të komentojnë se ata kanë qasje në sistemin e drejtësisë dhe marrin informata lidhur me punën e tyre, gjithashtu kanë bashkëpunimin me prokurorët dhe gjykatat.

Peja këtu bënë një përjashtim, ku komentet në fokus grupe sygjerojnë se "gazetarët nuk kanë qasje në asnjë seancë gjyqësore qoftë ajo e rëndësishme apo e parëndësishme, dhe nuk mbahet asnjë konferencë

"Qytetarët kanë filluar të vetëdijesohet" – fokus grupi në Mitrovicën jugore

shtypi pas këtyre seanceve”¹³. Një gazetar nga rajoni ankohet se “procedurat për qasje në zyren e prokurorit janë burokratike dhe kontakti direkt është shumë i vështirë. Nuk ka informacion të qartë për të drejtat tona për t’u takuar me zyren e prokurorit.” Një tjetër gazetar nga Prizreni pati mendimin e njëjtë: “Qasja është shumë e vështirë për OJQ-të dhe mediat edhe në Prizren.”

Sidoqoftë, shumë gazetarë dhe përfaqësues tregojnë se qasja në informacione në gjykata është më e lehtë për ata sesa për qytetarët e thjeshtë. “Njerëzit të cilët lejohen në zyren e prokurorit zgjedhen nga prokurori që do të thotë se ka qasje vetëm për ata të cilët prokurori i lejon si dhe organizatat për të drejtat e njeriut”¹⁴. Pjesëmarrësit e fokus grupeve gjithashtu e kanë të paqartë se nga mund të marrin të dhënat dhe cilave informata mund t’u qasen (dhe cilat janë të besueshme), edhe pse shumë përmendin se interneti është një burim kryesor i informatave.

3.2.4 Perceptimi për raportim të papërshtatshëm të mediave mbi krimin

Në komunitete të mbyllura në Kosovë, thashethemet përhapen shpejt. Njerëzit dëgjojnë ngjarjet nga të tjerët para se të lexojnë në gazeta për to. Sidoqoftë, njerëzit shpesh nuk i dinë detajet e ngjarjeve dhe mbetet vetëm të dëgjojnë lajmet që t’i kuptojnë ato. Disa të intervistuar dhe pjesëmarrës në fokus grupe u ankuan se ndonëse lexojnë në gazeta për ndonjë arrest, për procesin e mëtutjeshëm nuk shkruan më gazeta dhe shumë njerëz supozojnë se gjykimi nuk ka sjellë asnjë rezultat pozitiv.

Mungesa e përcjelljes së ngjarjeve krijon mundësi për korrupsion, meqë të dyshuarit janë akuzuar se kanë dhënë mito për të ulur dënimin ose për të dalë më herët nga burgu pa e vënë re mediat. Gjithashtu, është e vërtetë edhe thënia se njerëzit janë akuzuar padrejtësisht (dhe akuzat e publikuara në mediat lokale) dhe ka shumë pak mundësi që ata të “pastrojnë emrin e tyre” edhe pasi t’u hiqen akuzat.

“Në vend që të ofrohen më shumë informacione mbi rastet e krimit dhe drejtësisë për të cilat qytetarët janë më shumë të interesuar, mediat transmetojnë programe ose telenovela latine” – pjesëmarrës mashkull, fokus grupi nga Peja

¹³ Fokus grupi me femra, Pejë

¹⁴ Përfaqësues i një OJQ-je për të drejtat e njeriut

Ofrimi i informacioneve në komunitetet serbe të Kosovës

Komunitetet serbe në Kosovë e kanë shumë të vështirë të gjejnë të dhëna lidhur me sistemin e gjykatave të Kosovës për disa arsye. Të dhënat shpeshherë nuk përkthehen në gjuhën serbe (ose përkthehen në mënyrë të gabuar), por përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë nuk i njohin institucionet e Kosovës të cilat u sigurojnë disa të dhëna në gjuhën serbe (siç janë ligjet e publikuara në internet në tri gjuhë). Veç kësaj, institucionet e Kosovës nuk u adresohen këtyre komuniteteve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe mediat të cilat raportojnë për punën e institucioneve të Kosovës jo gjithmonë transmetohen te komunitetet serbe të Kosovës. Për shembull, në Kosovë nuk ka gazetë në gjuhën serbe.

Siç tregojnë pjesëmarrësit e fokus grupeve në Mitrovicën veriore "në një mënyrë, komuniteti serb i Kosovës nuk i pranon institucionet e menaxhuara nga Prishtina, por nga ana tjetër përfaqësuesit e komunitetit nuk ndihen të shërbyer dhe jo të barabartë pasi që ata nuk marrin të dhëna nga këto institucione". Problemi është i dyanshëm: Anëtarët e komunitetit serb të Kosovës nuk e shohin të arsyeshme t'u japin të dhëna institucioneve të drejtësisë dhe IPVQ-ve për çështjet që kanë të bëjnë me implementimin e ligjeve, policinë dhe funksionimin e gjykatës.

Situata është pak më ndryshe në enklavën serbe të Graçanicës, ku ka pak gatishmëri për të marrë informata nga IPVQ-të, por mediat që japin informata në tërë Kosovën nuk raportojnë në Graçanicë. Një pjesëmarrës i fokus grupit pohoi se "RTK nuk ka emision në gjuhën serbe dhe poashtu është e pamundur të transmetohet në Graçanicë.... radio stacionet lokale merren me problemet lokale dhe ne jemi prapë të ndarë nga Prishtina." [Shih www.rtklive.com për informacione rreth programit në gjuhën e tyre].

3.2.5 Besimi i pabarabartë në ShPK-në

Përgjithësisht, shumë pjesëmarrës kanë besim në ShPK dhe janë gjithnjë e më shumë të kënaqur me punën e tyre. Ende ka probleme lidhur me profesionalizmin e policëve dhe ka komente që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe trajnimin e pamjaftueshëm, megjithatë të gjithë e pranojnë se ShPK-ja ka përparuar shumë. Sidoqoftë, në diskutime të fokus grupeve dhe intervista u shfaqën dyshime ndaj ShPK-së, përfshirë edhe Pejën, ku ka probleme të vazhdueshme me sistemin e drejtësisë, duke përfshirë dhe ShPK-në.

Besimi në ShPK në mesin e të intervistuarve të komunitetit serb është shumë i ulët (edhe pse ata shprehën disa mendime pozitive për punën e ShPK-së dhe kuptimin e vështirësive me të cilat ballafaqoheshin). Policët e ShPK-së, në rajonet e pjesës veriore në komunat me shumicë serbe shihen si njerëz pa iniciativë, të paaftë dhe me kualifikime të dyshimta. Pjesëmarrësit deklaruan se shumë policë të ShPK-së kanë bashkëpunim me të ashtuquajturat "struktura paralele të sigurisë" siç janë "Rojet e Urës" dhe policia sekrete serbe. Kjo është perceptuar si pozitive nga një pjesë e komunitet serb të Kosovës, pasi që kjo lidhë policët e ShPK-së më shumë me "anën serbe", por të

"Besoj se ShPK-ja është duke bërë një punë të mrekullueshme duke marrë parasysh rrethanat, dhe është e vërtetë – ata janë të kufizuar me sistemet ekzistuese paralele gjyqësore. Askush nuk pret që kjo situatë të përmirësohet kur kemi struktura jofunksionale, thjesht nuk është e arsyeshme" – përfaqësues mashkull i një OJQ-je nga Mitrovica veriore

tjerët i shohin këto lidhje si “hapësirë për korrupsion dhe manipulim”. Gjithashtu, ekziston edhe një përshtypje se ShPK-ja zakonisht nuk intervenon në kohë kur vie deri te dhuna ndëretnike dhe krimet me motive etnike, gjë që kufizon kapacitetin e saj për të shërbyer si lidhje efektive me sistemin gjyqësor.

Në Graçanicë, çështja deri diku është e lidhur me etninë e policëve dhe pjesërisht ka të bëjë me çështje më të gjëra të korrupsionit: “Banorët e komunitetit serb nuk u besojnë pjesëtarëve të komunitetit shqiptar të ShPK-së... pjesëtarët nga komuniteti serb të cilët punojnë në ShPK nuk kanë autoritet dhe zakonisht janë ish-kriminelë”. Pavarësisht nga kjo, është treguar përkrahje për patrullat shumëetnike të ShPK-së, jo vetëm në rajonet e komunitetit serb, por në tërë Kosovën.

Komunitetet minoritare, të cilat janë të integruara në shoqëri më të gjerë, kanë mendime pozitive lidhur me ShPK-në. Pjesëmarrësit e fokus grupeve të komunitetit serb dhe atij goran në rajonin e Ferizajt kanë raporte të mira me ShPK-në: “Ne u jemi mirënjohës (ShPK-së). Ata vizitojnë fshatin tonë dhe gjithmonë pyesin nëse kemi ndonjë problem. Pra, ka marrëdhënie të mira ndërmjet fshatarëve dhe ShPK-së.”

3.2.6 Kapaciteti i dobët dhe perceptimi për korrupsion në sistemin e drejtësisë

“Kemi rreth 9,000 raste të pazgjidhura” – anëtarë i lartë i gjyqësisë, Ferizaj

“Kemi rreth 2,500 raste të pazgjidhura penale, rreth 5,000 raste civile dhe shumë të tjera” – anëtar i gjykatës komunale, Ferizaj

Është e qartë se korrupsioni dhe perceptimi i korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë është një shqetësim i madh për të intervistuarit. Sidoqoftë, nuk është edhe aq e qartë nëse zgjidhja më e mirë do të ishte luftimi i korrupsionit apo

kushteve të cilat lejojnë të krijohet, si numri i madh i rasteve të pazgjidhura, pagat e ulëta të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konfuziteti për llojet e ndryshme të ligjeve, kompetencat kundërthënëse, si dhe mekanizmat e dobët të mbikqyrjes.

“Është turp që në gjykata kemi mungesë të gjërave themelore si lapsa kimik, lapsa, letër ose gjëra tjera që nevojiten për punë” – Mashkull në FG, Prizren

Ankesa e zakonshme e prokurorëve, policëve, gjyqtarëve dhe qytetarëve ishte mungesa e gjyqtarëve¹⁵, që çon drejt një rritje të

“Një grup është dënuar me 70 vjet burgim për krim të organizuar. Pas gjykimit, prokurori përfundoi ditën e tij të punës dhe shkoi me transport publik në shtëpi. Aty ishin duke pritur anëtarët e familjeve të të gjithë të dënuarve. Mund të imagjinoni se çfarë ka mundur t’i ndodhë atij” – gazetar.

rasteve të pazgjidhura dhe kjo shkakton frustrim ekstrem tek njerëzit të cilët presin që rastet e tyre të zgjidhen, si dhe shkakton probleme me kohën e gjatë të paraburgimit për të dyshuarit të cilët më pastaj lirohen.

Një shkaktar i mundshëm që i ndal njerëzit të bëhen gjykatës është

¹⁵ Në Prill 2007, ishin 311 gjyqtarë dhe 88 prokurorë lokal në Kosovë, sipas Faqes së Fakteve të UNMIK-ut, që mund të gjendet në adresën: http://www.unmikonline.org/docs/2007/Fact_Sheet_apr_2007.pdf (qasur së fundi me 16 Nëntor 2007). Kjo do të thotë një gjykatës lokal për 6,430 njerëz. Nëse krahasohen, në Maqedoni është një gjykatës për 3,210 njerëz (numër relativisht i madh) (burimi: Nationmaster.com).

mungesa e sigurisë për gjykatës, e sidomos për ata të cilët punojnë me rastet e krimeve serioze. Disa gjykatës dhe prokurorë kanë shprehur frikë për sigurinë e tyre nëse do të merrnin vendime të cilat do të ishin të pafavorshme për familje të fuqishme, grupe të organizuara kriminale dhe individë tjerë. Shqetësimet e sigurisë keqësohen kur një rast nuk është në sy të publikut; publikimi i rasteve u përmend si një veprim që do të ofronte mbrojtje nga kërcënimet. Pagat e ulëta për gjyqtarët gjithashtu mund të jenë dëshpëruese për të rinjtë që i bashkohen këtij profesioni. Pagat e ulëta të gjyqtarëve shihen si një nga nxitësit kyç të korrupsionit në gjyqësi, dhe kombinuar me numrin e madh të rasteve këto shpesh janë shembuj pse njerëzit paguajnë që rastet e tyre të zgjidhen më shpejtë.

Gjykatat nuk kanë buxhet të vetin. Këshilli Gjyqësor i Kosovës vendos mbi fondet për shpenzimet administrative të gjykatave, si dhe për pagat e prokurorëve dhe gjykatësve, kurse Ministria e Drejtësisë vendosë mbi fondet për shpenzimet administrative të prokurorisë. Kjo parandalon gjykatat që të marrin iniciativa, për

Rast për studim: korrupsioni në zemër të sistemit të drejtësisë

"Kam pasur një herë një rast në Gjykatën komunale në Prishtinë, dhe ky më bëri të mendoj se sistemi i drejtësisë në Kosovë është i korruptuar. Nëse gjykatësi është i korruptuar kuptohet që i tërë sistemi është i korruptuar. Dyqani im më është grabitur dhe vlera ka qenë disa mijëra euro. Njerëzit të cilët kanë punuar për mua më kanë vjedhur dhe ata janë kapur nga ShPK-ja. Policët e ShPK-së kanë regjistruar të gjitha ndodhitë e grabitjes konkrete.

"Çfarë dua të them është se përkundër dëshmime, fotove dhe regjistrimeve të policisë, ata që më kanë vjedhur janë liruar pas disa ditëve dhe arsyeja ka qenë mungesa e dëshmimeve. E kam ditur se sistemi është i korruptuar dhe kjo ishte arsyeja pse kam dashur që policia të regjistroj këtë vjedhje, por prapë nuk më ka ndihmuar. Më vonë kam angazhuar edhe një avokat, por më vonë e kam kuptuar se edhe avokati është i korruptuar. Ai nuk më ka informuar mbi rastin dhe ai as që është paraqitur në gjykatë, dhe kështu gjykatësi i ka liruar personat që më kanë vjedhur. Kjo do të thotë se zyrat e avokatëve janë të lidhura me gjykatës, etj. Kam provuar të angazhoj edhe një avokat tjetër, por ai më ka thënë se për 4.000 euro gjithçka do të zgjidhej, që është edhe një dëshmi tjetër për korrupsionin në këtë sistem" – pjesëmarrës i fokus grupit.

shembull të zhvillojnë programe për qasje apo komunikim me komunitet, përmirësim të qasjes fizike ose publikim të broshurave me informacione mbi gjykatat lokale. Një sugjerim nga një gjykatës i intervistuar gjatë kësaj analize ishte decentralizimi i buxhetit të gjykatave. Nëse kjo do të bëhej (për shembull, si pjesë e procesit të decentralizimit), sisteme financiare të sigurta dhe transparente do të duhej të vendoseshin për të parandaluar rreziqe tjera të keqmenaxhimit financiar apo korrupsionit.

3.2.7 Qasja e vështirë në gjykata

Derisa shumica e anëtarëve të publikut fizikisht kanë qasje në gjykatat në të cilat kanë nevojë, ekzistojnë disa probleme me qasje për grupe të veçanta të njerëzve, dhe një pjesëmarrës i fokus grupit në Shtime u ankua se ai nuk mund të hyjë në gjykatë fare pasi që nuk ekziston gjykata në komunën e tij.

Gjykatat janë të vendosura në qytete dhe qyteza të mëdha, dhe mund të jetë paksa vështirë për njerëzit që vijnë nga vendet rurale që të përdorin këto shërbime.

Kufizimet në lirinë e lëvizjes për disa komuna kufizojnë qasjen e tyre në ndërtesa të gjykatave. Në Mitrovicë, Gjykata e Qarkut është e vendosur në pjesën veriore të qytetit, dhe kështu e bënë të vështirë për njerëzit nga ana jugore që të shkojnë atje. Ekziston një autobus i caktuar posaçërisht për transportimin e njerëzve nga ana jugore tek gjykata në veri, por kjo zgjat më shumë se ecja në këmbë dhe kushton më shtrenjtë se një biletë e zakonshme autobusi. Njëjtë, serbët e Kosovës nga Graçanica kanë vështirësi në qasjen në Gjykatën komunale në Prishtinë, pjesërisht për shkak të tabelave të regjistrimit të veturës, (shih seksionin 5.1) dhe kështu frikësohen të udhëtojnë në Prishtinë, dhe pjesërisht për shkak se ndjehen të papërfaqësuar nga të punësuarit në gjykata.

Qasja fizike gjithashtu mund të jetë e vështirë për njerëzit me aftësi të kufizuara, dhe për këtë duhen plotësuar nevoja të veçanta (si qasja për karroca invalidësh) gjatë planifikimit të ndërtesave të gjykatave.

Studentët në fokus grupe u ankuan se nuk kanë qasje në gjykata, duke u ndjerë kështu se nuk merreshin seriozisht nga zyrtarët gjyqësor nëse do të dëshironin ndonjë informacion nga gjyqi.

3.2.8 Mungesa e mbrojtjes efektive të dëshmitarëve dhe viktimave

Ekziston një ndjenjë hutie totale në mes profesionistëve gjyqësor dhe publikut mbi ekzistimin e masave zyrtare për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, por gjithashtu ekziston edhe pothuajse një marrëveshje se në praktikë dëshmitarët dhe viktimat nuk janë të mbrojtur. Njerëzit ndjehen shumë të pasigurt, dhe frikësohen se ata ose familja e tyre mund të rrezikohen nëse dëshmojnë kundër ndonjë të akuzuari, por edhe viktimat gjithashtu mund të ngurrojnë në raportimin e krimit (dhe të përcjellin rastin). Në disa raste kjo lidhet me praninë e komuniteteve të mbyllura në Kosovë, me raportimin e papërgjegjshëm të mediave, dhe me shembujt ku ShPK-ja dhe prokurorët zbulojnë ose tregojnë informacione në lidhje me

“Një herë kam parë një krim por nuk kam shkuar në gjykatë për të dëshmuar. Nuk jam ndjerë i sigurt” – pjesëmarrës i fokus grupit në Prishtinë

“Në vendin tim...”: gjykatësit ndërkombëtarë në Kosovë

Ekziston një nivel i lartë i konsensusit se gjykatësit ndërkombëtarë shpesh nuk janë po aq kompetent sa gjykatësit vendor për shkak se nuk e kuptojnë kulturën dhe ‘mentalitetin’ kosovar. Shumica e pjesëmarrësve të fokus grupeve do të dëshironin të gjykoreshin nga gjykatës vendor, edhe pse disa pranuan se në krimet e ndjeshme, si incidentet ndëretnike, një gjykatës ndërkombëtarë do të ishte më i përshtatshëm. Pagat e larta të gjykatësve ndërkombëtarë janë përmendur shpesh, ku disa pjesëmarrës besonin se kjo parandalonte korrupsionin dhe se ishte shumë pozitive, dhe të tjerët argumentonin se dallimi i pagës është edhe një shembull tjetër i standardeve të dyfishta. Disa ngritën edhe çështjen e truprojave të gjykatësve ndërkombëtarë, përsëri diçka që zvogëlon mundësitë për korrupsion dhe demonstroi se sa të pasigurt mund të ndjehen gjykatësit vendor në punën e tyre të përditshme.

identitetin e dëshmitarëve (pjesërisht ka të bëjë me korrupsion dhe pjesërisht me pakujdesi dhe joprofesionalizëm).

Pa dëshmitarë, dhe duke marrë parasysh se ShPK-ja dhe prokurorët duket se kanë mungesë të aftësive për mbledhjen dhe analizimin e materialeve për dëshmi si dëshmi të mjekëve ligjorë dhe ballistikës, rastet shpesh dështojnë ose nuk arrijnë në

gjykatë. Ky mosfunksionim në sistemin e drejtësisë kontribuon në përdorimin e mekanizmave jozyrtar të drejtësisë dhe kështu mund të dëmtojnë sistemin zyrtar të drejtësisë ose të çojnë drejt drejtësisë jozyrtare që nuk i plotëson standardet e të drejtave të njeriut.

"Gjykatat duhet vendosur për rastet kur lejohet kaucioni"; "Rregullat e kaucionit duhen vendosur me ligj"
– pjesëmarrës mashkull i fokus grupit në Gjakovë

3.2.9 Dënimi dhe kaucioni

Pjesërisht për shkak të korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë, dhe pjesërisht si rezultat i raportimit përcjellës të

papërshtatshëm nga media, (shih seksionin 3.2.4), ekziston një perceptim se shumë kriminelë kanë marrë dënime shumë të lehta për ashpërsinë e krimit. Një shembull i dhënë nga një pjesëmarrës i një fokus grupi në Mitrovicën jugore përfshinë të dyshuarit për një rast dhunimi të një fëmije, të cilëve u është shqiptuar dënimi i arrestit shtëpiak, dhe një pjesëmarrës i një fokus grupi në Gjilan deklaroi se dikush i akuzuar për vrasje kishte filluar të punonte në sistemin e edukimit. Shqetësimet gjithashtu janë shprehur se korrupsioni mund të ndryshoj vendimin nga 'fajtor' në 'i pafajshëm': "faktorë të ndryshëm ndikojnë rastet ku krimi është i njëjtë por dënimi i ndryshëm".

"Kaucioni nuk është i nevojshëm për kriminelë. Ata lirohen edhe pa pagesë"
– pjesëmarrës i fokus grupit në Graçanicë

Pagesa e dënimit me para gjithashtu konsiderohet në dy mënyra nga shumica e njerëzve të intervistuar, ku disa pjesëmarrës të fokus grupeve përmenden se nga kjo ose përfitojnë të pasurit ose u mundësohet të dyshuarve të paguajnë me para dënimin me burg. Kjo lidhet ngushtë me shqetësimet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave, siç e përmendi një pjesëmarrës i fokus grupit në Gjilan: "Kaucioni nuk është i mirë për shkak se u mundëson të akuzuarve të ikin nga vendi, të blejnë dëshmitarët ose t'i manipulojnë ata, dhe shkaktojnë zhdukje të dëshmitarëve."

3.2.10 Mekanizmat jozyrtar të drejtësisë

Duke marrë parasysh dështimet e sistemit zyrtar të drejtësisë, shumë njerëz i kthehen mekanizmave jozyrtar për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Disa nga këto janë shembuj pozitiv të iniciativave për bisedime ose formulimit të zgjidhjeve specifike për komunitetet që vlejnë për të gjithë, dhe që mund të ndihmojnë në uljen e presionit ndaj sistemit të mbingarkuar zyrtar të drejtësisë. Për shembull, në një fshat të Ferizajt, ekziston një Këshill i përbashkët në mes serbëve dhe shqiptarëve për zgjidhjen e përbashkët të problemeve. Një pjesëmarrëse femër në Gjakovë komentoi se mosmarrëveshjet mbi pronën "zakonisht zgjidhen me marrëveshje në mes dy personave të përfshirë, dhe jo nëpërmes gjykatave." Por të tjerët janë më pak pozitiv, e në veçanti disa nga ta përdorin Kanunin e Lekë Dukagjinit, i cili është përmendur më së shpeshti në lidhje me mosmarrëveshjet pronësore (sidomos brenda familjeve). Kanuni interpretohet dhe përdoret nga njerëz të ndryshëm në vende dhe kohë të ndryshme dhe kështu ekziston një huti dhe një mospërputhje në përdorimin e tij¹⁶. Kanuni duket të jetë më dominues në vendet rurale, dhe i lidhur

¹⁶ Ekziston një huti e madhe se si ose nëse Kanuni i Lekë Dukagjinit përdoret në realitet. Shpesh i janë referuar në dy fokus grupet dhe intervistat me zyrtarë gjyqësor, por si duket shpesh lidhet me idenë e hakmarrjes (përfshirë gjakësitë), derisa njerëzit tjerë ndajnë plotësisht nga Kanuni çështjet e lidhura me hakmarrje. Nevojiten më shumë hulumtime për të parë saktësisht se si përdoret Kanuni (dhe ku nuk përdoret, përkundër deklaramëve të njerëzve). Më shumë diskutime dhe informacione mbi

deri diku me hezitimin që banorët rural nganjëherë e shprehin kur kanë të bëjnë me sistemin zyrtar të drejtësisë (të vendosur në qytet).

"Ende ekzistojnë raste kur ne zgjidhim problemet në dy mënyra, e para nëpërmes gjykatave dhe e dyta nëpërmes Kanunit. Ka ndodhur që pas zgjidhjes së rastit në gjyq, njerëzit janë munduar t'i zgjidhin problemet me dhunë." – pjesëmarrës në një fokus grup të shqiptarëve dhe goranëve në Ferizaj

Shumë të intervistuar thanë se Kanuni i Lekë Dukagjinit kryesisht përdoret në rastet e hakmarrjes, dhe disa përfaqësues të OJQ-ve argumentuan se Kanuni shpesh keqpërdoret dhe keqinterpretohet.

Disa vende të Kosovës, sidomos në rajonin perëndimor, kanë përjetuar armiqësi gjaku në mes familjeve; këto shpesh janë perceptuar si të lidhura me Kanun, dhe

Rast për studim: "Fjala" e faljes

"Dy familje, njëra nga njëri fshat (në Ferizaj) dhe tjetra nga Shtimja ishin në armiqësi me njëra tjetrën. Anëtari i familjes nga Ferizaj ishte në burg për shkak të vrasjes që kishte kryer, dhe edhe gjatë kësaj kohe familja e tij nuk e kishte "fjalën" (e faljes) nga familja tjetër. Fëmijët nuk shkonin në shkollë për shkak se ishin të frikësuar, dhe anëtarët tjerë të familjes ishin të izoluar në shtëpinë e tyre. Duke pas parasysh këtë informacion, dhe shumë raste të hakmarrjes, një "Këshill i pajtimit" u themelua për Kosovë, dhe ky Këshill arriti t'i pajtoj këto dy familje. Sot, anëtarët e familjes nga (Ferizaj) jetojnë të lirë. Si rezultat i kësaj, mund të them se në vendet rurale, aty ky gjykatat as nuk punojnë, ose nuk informojnë qytetarët, këshillat jozyrtare luajnë një rol thelbësor." – Gazetar

reflektojnë vlerat tradicionale shqiptare të krenarisë dhe nderit. Dështimi i sistemit zyrtar të drejtësisë për të ofruar mbrojtje të përshtatshme për dëshmitarë dhe viktime keqëson situatën, dhe njerëzit shpesh nuk janë të sigurt as nëpër burgje. Për më shumë, sistemi zyrtar i drejtësisë në rastet e armiqësisë me gjakmarrje nuk duket të ofroj përmirësime për ndonjë gabim të ndodhur, dhe kështu pas daljes nga burgu armiqësia vazhdon, nëse gjakatarit nuk ka kërkuar faljen ("fjalën") dhe nëse ajo nuk i është dhënë.

Por, mekanizmat jozyrtar gjithashtu mund të ofrojnë pajtime me përdorimin e Kanunit, nëpërmes shembujve të këshillave të pajtimit ose individëve të respektuar nga ndonjë komunitet.

Në një fokus grup të mbajtur me studentë në Mitrovicën veriore, nuk kishte njohuri mbi mekanizmat jozyrtar të përdorur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi tokën dhe pronën, por pjesëmarrësit argumentuan se aty ku sistemet zyrtare të drejtësisë funksionojnë dhe njihen nga të gjitha komunitetet, çfarëdo mekanizmi jozyrtar do të perceptohej si kërcënim për shkak se natyra e tij nuk do të ishte parandaluese dhe edukuese. Sidoqoftë, përfaqësues të OJQ-ve në një tjetër fokus grup në vendin e njëjtë, vërejtën një rritje të dukshme të mekanizmave jozyrtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sidomos në lidhje me personat serbë të zhvendosur brenda vendit (PZhBV) në Kosovë nga qendrat urbane të Kosovës si Prishtina dhe Prizreni.

përmbytjen dhe përdorimin e Kanunit gjithashtu do të ishin të dobishme për shoqërinë e Kosovës, në përgjithësi, për të kuptuar atë plotësisht.

Në këto raste, kontaktet dhe zgjidhjet e mosmarrëveshjeve bëhen direkt në mes anëtarëve të komunitetit serb të Kosovës dhe shqiptarë të Kosovës.

Që të dy fokus grupet në veri të Mitrovicës komentuan mbi përdorimin e anëtarëve të "Rojëve të Urës"¹⁷, policisë së fshehtë serbe dhe manastireve si ndërmjetësues në "mosmarrëveshjet e vogla" si përdorimi i drogës, mosmarrëveshjet familjare dhe dhuna ndër-rinore.¹⁸ Kisha Ortodokse Serbe (KOS), sidomos manastiret, luanë një rol jo vetëm kulturor, fetar dhe tradicional, por luan edhe rolin e këshilltarëve dhe ndërmjetësuesve, duke e bërë kështu KOS-në një nga mekanizmat jozyrtar më të fuqishëm për adresimin e problemeve të zakonshme të anëtarëve të komunitetit serb të Kosovës.

Rast për studim: Marrja e drejtësisë në duart tua

Do t'ju rrëfej tregimin tim. Në vitin 2005 tri bomba u gjuajtën në Prishtinë dhe unë shkrova një artikull mbi këtë ndodhi në gazetën lokale. Ditën tjetër disa persona, të cilët dukeshin të ishin shumë të rëndësishëm, erdhën tek unë dhe më kërcënuan, dhe kështu unë i lajmërova në polici. Edhe pse ata e dinin se unë i kam lajmëruar në polici, ata erdhën përsëri tek unë. Policia nuk ndërmori asnjë masë. Kjo është arsyeja pse unë pata nevojë të përdorë vëllezërit dhe familjen time për të më mbrojtur, sepse ata ishin të informuar detalisht mbi rastin tim që është raportuar në polici." – pjesëmarrës në fokus grup.

Mekanizmat jozyrtar: dilema për komunitetin rom

Përdorimi i mekanizmave jozyrtar të dominuar nga serbët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mund të jetë shumë problematike për komunitetin rom që jeton në vendet me shumicë serbe. Në shumicën e rasteve ku ka nevojë të adresohet një problem në mes komuniteteve të romëve dhe serbëve të Kosovës, "Rojet e Urës" mund të intervenojnë. Sidoqoftë, sipas disa pjesëmarrësve të fokus grupeve në shumë raste zgjidhja e problemit mund të mos jetë në interesin më të mirë të komunitet rom, për shkak se "Rojet e Urës" tentojnë të mbrojnë interesat e komunitetit serb të Kosovës. Kështu ata nuk do të ishin zgjedhja e parë e mekanizmave jozyrtar nga perspektiva e komuniteti rom. Për të shmangur probleme shtesë, komuniteti rom ngurron që të raportoj këto lloje të "rasteve të zbutjes së konfliktit" në ShPK, pasi që ShPK-ja kryesisht ka staf policë serbë të Kosovës dhe perceptohet se ata punojnë, jozyrtarisht, në bashkëpunim me "Rojet e Urës".

3.3 Rekomandime për përmirësimin e qasjes në drejtësi

¹⁷ Të ashtuquajturit Rojat e Urës janë një grup meshkujsh serbë të Kosovës me detyrën e vetëpërcaktuar për të "ruajtur" urën kryesore që kalon mbi Lumin Ibër në Mitrovicë me qëllim të monitorimit të atyre që kalojnë urën për në Mitrovicën veriore.

¹⁸ Pjesëmarrësit e bënë të qartë ndarjen në mes manastireve dhe kishave, dhe thanë se u besojnë më shumë murgjve në manastire se priftërinjve në kisha, për shkak të qëndrimit të përhapur se priftërinjtë janë duke keqpërdorur njerëzit për përfitime personale, duke i detyruar të paguajnë edhe për shërbimet më të vogla, derisa murgjit në manastire ofrojnë shërbimet e tyre pa pagesë dhe janë më të sjellshëm.

3.3.1 Konsolidimi i roleve dhe përgjegjësive në sektorin e drejtësisë

Konsolidimi i roleve, përgjegjësive dhe përgatitjet më të mira trajnuese në sektorin e drejtësisë janë faktorë të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimit shpërndarjes, përgjegjësive dhe rritjen e aftësive. Ekzistojnë disa mënyra në të cilat kjo mund të arrihet:

- **Sqarimi i ndarjes së kompetencave:** Vepruesit në sektorin e drejtësisë i kanë ende të paqarta funksionet e sakta dhe mandatet e tyre, veçanërisht kur përfundon funksioni i ShPK-së dhe fillon funksioni i prokurorit. Gjithashtu, ka ende paqartësi nëse vepruesit e Kosovës ose ata ndërkombëtarë (UNMIK-u) janë përgjegjës për çështje të caktuara, veçanërisht prokurorët vendor dhe ndërkombëtar. Kjo duhet sqaruar si çështje urgjente.
- **Krijimi i policisë gjyqësore:** Krijimi i policisë gjyqësore është edhe në mandat nga ligji, por ende nuk është bërë asgjë lidhur me këtë. Prokurorët, policët dhe gjykatësit këshillojnë se krijimi i policisë gjyqësore do të ishte një hap pozitiv në qartësimin e përgjegjësive, zvogëlimin e detyrave në gjykata dhe vënien e njerëzve të duhur në administrimin e hetimeve.
- **Trajnimi i prokurorëve:** Kur prokurorëve u dhanë role hulumtuese në prill të vitit 2004, thuhet se ata kishin kryer shumë pak trajnime mbi atë se si të drejtojnë hetimet. Pakënaqësitë si nga ShPK-ja ashtu edhe nga gjykatësit lidhur me punën e prokurorëve iu referuan kësaj mungese se si të kryhen punët hetimore. Sigurimi i trajnimeve të planifikuara për prokurorët në udhëheqjen e hetimeve është një hap thelbësor në ndërtimin e kapacitetit dhe në këtë mënyrë përmirëson kapacitetin për tërë sistemin e drejtësisë.
- **Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë:** Ka shumë probleme lidhur me bashkëpunimin dhe komunikimin mes punëve të ShPK-së, prokurorëve dhe gjykatave. Me kompetenca më të qarta, njësi profesionale të policisë gjyqësore dhe prokurorë të trajnuar, bashkëveprimi në mes këtyre institucioneve do të forconte këtë bashkëpunim tutje:
 - **Trajnimet e përbashkëta:** Duke trajnuar bashkë vepruesit e ndryshëm, ata do të kuptonin më mirë rolet dhe përgjegjësitë e secilit, si dhe do të zhvillonin besim dhe respekt reciprok.
 - **Takimet e vazhdueshme:** Disa prokurorë dhe policë të ShPK-së tashmë mbajnë mbledhje të vazhdueshme për të diskutuar rreth punëve të tyre dhe e pranojnë se kjo do të ndikoj pozitivisht në bashkëpunim dhe efikasitet në punë. Sidoqoftë, kjo gjë nuk ndodh në tërë Kosovën. Duhet të bëhen kërkesa që të mbahen mbledhjet dhe të mbahen procesverbale dhe t'u shpërndahen të gjitha palëve të interesuara. (nuk është i mjaftueshëm vetëm komunikimi verbal nga pikëpamja për të kërkuar përgjegjësi nga njëri-tjetri).
 - **Komunikimi më i mirë:** Derisa ShPK-ja dhe prokurorët komunikojnë mes veti në shumicën e rajoneve të Kosovës, kjo shpesh nuk është bërë formale. Protokollet e veçanta të komunikimit duhet të zhvillohen bashkërisht nga ShPK-ja dhe zyra e prokurorit për të garantuar se të dy institucionet kanë marrë informacione të mjaftueshme dhe se problemet dhe mospërputhjet mund të identifikohen lehtë.

3.3.2 Sqarimi i bazës ligjore

Mungesa e qartësimi se cilat baza ligjore aplikohen krijon zemërim dhe konfuzion në mesin e të intervistuarve. Për më tepër, është në interesin e disa njerëzve që të parandalojnë këto fusha ligjore “ngjyrë hiri” të lejojnë korrupsionin, prishin autoritetin e IPVQ-ve dhe kthejnë popullin kundër institucioneve. Shumë nga kjo lidhet në mënyrë direkte me statusin e përkohshëm të Kosovës dhe pozitave politike në negociatat e statusit përfundimtar dhe kështu nuk mund të ndalohen në këtë kohë. Sidoqoftë, ekziston një mundësi për të **sqaruar kur rregulloret e UNMIK-ut ose ligjet e Kosovës (para dhe pas vitit 1999) janë të aplikueshme.**

3.3.3 Përmirësimi i qasjes në gjykata

Nganjëherë është e vështirë qasja fizike në gjykata dhe njerëzit shpesh janë të painformuar se si mund t'i qasen gjykatave dhe të dhënave për institucione tjera të drejtësisë dhe për gjykata.

- **Të gjejnë të dhëna të sakta** : institucionet e drejtësisë duhet të japin të dhëna më të sakta (për shembull, në broshura dhe shpallje) se si mund t'u qasen atyre, numrat e telefonit dhe pikat e kontaktit dhe gjithashtu të tregojnë edhe funksionet dhe përgjegjësitë që kanë.
 - Ky është problem edhe më i madh në komunitetet që janë të angazhuara pak me IPVQ-të. **Krijimi i vendeve ndërlidhëse të informimit** në komunitete më të mëdha ku banorët mund të pyesin për punët e qeverisë së Kosovës dhe institucionet e drejtësisë në njëfarë mënyre e plotësojnë këtë hapësirë të informatave.
 - Institucionet duhet të **përdorin edhe internetin** gjithashtu për të dhënë informacione (në të gjitha gjuhët e përshtatshme) lidhur me proceset e drejtësisë në përgjithësi dhe veçanërisht rastet publike, dhe gjykatat gjithashtu duhet të japin rregullisht **broshura informative lidhur me rastet e zgjidhura dhe të pazgjidhura** dhe t'i shpërndajnë në komunitet në mënyrë aktive.
 - Ka shumë pak **njohuri mbi qasjen tek avokatët pro bono** dhe cilat të drejta qytetare kanë të bëjnë me marrjen e avokatëve pro bono. Duhet të jepen më shumë informacione të sakta në këtë lëmi dhe puna e avokatëve pro bono duhet të monitorohet po aq rreptë sa kur ata kryejnë punë private.
- **T'u sigurojnë popullit qasje më të mirë në gjykata**: Gati të gjithë punonjësit e mediave dhe OJQ-ve ndjehen optimist në lidhje me qasjen e tyre tek zyrtarët e gjykatave dhe dokumentet, edhe pse disa menduan se kjo është vetëm sipërfaqësore. Zyrtarët e gjykatave duhet të zgjerojnë këtë marrëdhënie me të gjithë qytetarët, duke u treguar atyre orarin kur ata mund t'u qasen gjykatave dhe të dhënave të tyre, cilat seanca gjyqësore janë të hapura për publik, çfarë lloji të informacionit mund t'u qasen dhe cilat procese dhe institucione duhet t'i përdorin për këtë qasje. Gjithashtu është e rëndësishme për zyrtarët që të jenë në zyrat e tyre kur ata e caktojnë orarin.
- **Të trajtojnë të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë**: Është e domosdoshme që të gjithë njerëzit të trajtohen njësoj, pa marrë parasysh vendlindjen, gjininë, moshën, etnitetin ose profesionin. Do të ishte mjaft e dobishme që t'u jepen trajnime plotësuese zyrtarëve të gjykatës se si të shmangin diskriminimin kundër grupeve të caktuara të njerëzve.

- **Të përmirësojnë qasjen në gjykata në tërë Kosovën.** Për shembull, autobusi që dërgon njerëzit nga pjesa jugore e qytetit të Mitrovicës në gjykatën që ndodhet në pjesën veriore të qytetit është një zhvillim pozitiv, por duhet të jetë falas për të gjithë. Nëse pas kësaj njerëzit do të përdornin autobusin për punë që nuk kanë të bëjnë me gjykatë atëherë kjo do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e lirisë së qarkullimit më gjerësisht. IPVQ-të duhet të marrin parasysh të krijojnë një shërbim të ngjashëm të autobusëve për komunitetet tjera të Kosovës.

3.3.4 Fuqizimi i rolit të mediave

Mediat kanë rolin e informimit të publikut rreth krimeve në mënyrë dhe kohë të saktë. Shumë nga kjo tashmë është duke u bërë, por do të ishte mirë që ata të **përcillnin rastet gjatë procesit gjyqësor dhe procesit të vendimeve**. Kjo do të ndikonte jo vetëm në informimin më të mirë të publikut dhe mundësisë për të pasur mendimin e tyre në një rast të caktuar, por gjithashtu do t'u jepte mundësi policisë dhe prokurorëve për të pasur dëshmitarë dhe më shumë informacione rreth krimeve. Për më tepër, shpalljet transparente dhe të rrepta të vendimeve gjyqësore do të zvogëlonin mundësinë e korrupsionit, veçanërisht duke dhënë dënime të lehta dhe ndonjëherë edhe duke lejuar njerëzit të dalin nga burgu para kohës.

3.3.5 Përmirësimi i besimit në ShPK¹⁹

ShPK është një ndër institucionet më të fuqishme në sektorin e gjerë të drejtësisë në Kosovë, por në mesin e disa komuniteteve besimi është i ulët dhe në mesin e publikut më të gjerë ende ka hezitime për të raportuar krimet. Është shumë i rëndësishëm besimi i popullit në ShPK në mënyrë që ata të raportojnë krimet dhe kështu të zvogëlojnë shkallën e krimit dhe njerëzit të jenë të sigurt. Prandaj, ShPK-ja duhet të përqendrohet se si të **fitojë besimin e komuniteteve** ku besimi është i ulët, për shembull duke vazhduar dhe duke zgjeruar praktikën e patrullimeve shumëetnike, të këshillohen gjithmonë me komunitetet lokale dhe të përmirësojnë mënyrën e këshillimit.

Policët duhet të **ruajnë standardet më të larta të profesionalizmit** në çdo kohë. Kjo do të përfshinte sjelljen më të mirë dhe afrimin ndaj popullit, por policia duhet gjithashtu të mbajë distancë nga njerëzit me lidhje familjare në mënyrë që të mos jenë të padrejtë ndaj të tjerëve. Ata gjithashtu duhet të jenë profesional në marrëdhënie me prokurorët në veçanti, duke i përkrahur procedurat në çdo kohë.

ShPK-ja duhet të përpiket që të **mbaj publikun të informuar** lidhur me rastet kriminale kur kjo është e mundur ligjërisht, si dhe t'u japin mediave të dhëna në Kosovë rreth vazhimit të hetimeve. Njëjtë, ShPK-ja duhet të **përforcojë mënyrën e komunikimit me qytetarët** që të ndihmojnë policinë lidhur me informacione.

3.3.6 Adresimi i mungesës së kapaciteteve në sistemin gjyqësor

Mangësitë më kryesore në sistemin e drejtësisë nga një pikëpamje kanë të bëjnë me trajnimin e prokurorëve të papërshtatshëm dhe mungesën e gjyqtarëve. Derisa kapaciteti i këtyre vepruesve të ndërtohet drejtë (shih më lartë seksionin 3.3.1) ekzistojnë disa mënyra që të zvogëlojnë ngarkesën në këtë pjesë të sistemit të drejtësisë.

¹⁹ Shih *Policimi në Kosovë: Hulumtim i perceptimeve* (titull i përkohshëm), Saferworld dhe FIQ-i (pritet të publikohet) për më shumë detaje mbi qëndrimet ndaj ShPK-së dhe rekomandimet për përmirësimet në policim në të ardhmen.

- **Forcimi i institucionit të Ombudspersonit:** Zyra e Ombudspersonit duket se respektohet nga publiku, me njoftimet se qytetarët janë duke përdorur këtë institucion gjithnjë e më shumë, dhe institucionet tjera qeveritare dalëngadalë po i përgjigjen hetimeve të tyre. Ende ka vështirësi lidhur me mënyrën e qasjes te Ombudspersoni dhe mandati i tij/saj. Ky do të mund të ishte institucioni kryesor në përmirësimin e qasjes në informacione për publikun dhe garantimin që procesi është duke u përcjellur nga institucionet ligjore, dhe gjithashtu duhet të fuqizohet veçanërisht në periudhë më të shkurtë.
- **Fokusimi në gjykata dhe prokurorë:** Deri më tani, agjencitë ndërkombëtare dhe donatorët janë përqendruar në ndërtimin e kapacitetit të ShPK-së, gjë që ka ndikuar në vlerësimin e gjerë të punës së ShPK-së. Sidoqoftë, kjo arritje po krijon punë shtesë në gjykata të cilat nuk mund të përballen me punë shtesë në gjendjen e tanishme dhe ShPK-ja rrezikohet të fajësohet për këto mosuksese (si institucioni më i shquar). Kështu që, vëmendja duhet të përqendrohet në përmirësimin e aftësive të prokurorëve dhe gjykatësve (në zotësi, në numër dhe në premisat e tyre). Gjithë kjo duhet të bëhet në formë bashkëpunimi, duke pasur një qasje të “përbashkët” në zhvillimin e sektorëve të drejtësisë dhe sigurimit në Kosovë.
- **Largimi i rasteve të pakontestueshme nga gjykatat:** Për rastet më të thjeshta qytetare, një zgjidhje do të ishte që t’u jepen fuqi gjykuese gjykatave ose nëpunësve administrativ, të cilët do të zgjidhnin rastet që kanë të bëjnë vetëm me biznese ose çështjet e pakontestueshme, siç janë kontratat ose marrja e licencave.
- **Përdorimi i mekanizmave jozyrtar të drejtësisë:** Qytetarët janë duke përdorur mekanizma jozyrtar të drejtësisë për të zgjidhur mosmarrëveshjet që do të merrnin shumë vite për t’u zgjidhur në sistemin e gjykatave. Disa nga këto mekanizma mund të ndihmojnë në zvogëlimin e detyrave në sistemin e gjykatave, siç janë mbledhjet në fshatra duke marrë familje të respektuara dhe drejtues të fshatit për t’i zgjidhur mosmarrëveshjet. Sidoqoftë, këto mekanizma jozyrtar zakonisht nuk kanë sistem të “apeleve” dhe mund të jenë jotransparent dhe të papërgjegjshëm. Për më shumë, ato jo gjithmonë mbrojnë grupet apo palët më të “dobëta” nga ndonjë mosmarrëveshje dhe mund të përforcojnë strukturat patriarkale duke injoruar nevojat e domosdoshme për femra dhe fëmijë. Prandaj, çdo lloj përdorimi i këtyre sistemeve ose përkrahjes së tyre duhet të bëhet me shumë kujdes.

3.3.7 Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave të krimit

Ekziston një dispozitë në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale në Kosovë për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave të krimit brenda sallës së gjykatës. Kapitulli 21 – Mbrojtja e palëve të lënduara dhe dëshmitarëve (nenet 168-174 të këtij Kodi)²⁰ merret me këtë. Sidoqoftë, informacionet në lidhje me këtë janë konfuze dhe të vështira për t’u qasur. Si urgjencë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të **nis një fushatë mediale dhe të mbajë takime me komunitetet** për të informuar publikun mbi masat për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave të cilat tashmë ekzistojnë.

²⁰ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale në Kosovë, që mund të gjendet në adresën: http://www.unmikonline.org/regulations/2003/RE2003_26_PCPC.pdf (qasur së fundi me 8 nëntor 2007)

Një raport i nëntorit 2007 nga OSBE-ja²¹ përmban disa rekomandime të detajizuara për përmirësimin e mbrojtjes, përfshirë edhe masat për ndërrim të vendbanimit dhe masat tjera mbrojtëse afatgjata, dhe në veçanti rekomandimet për përmirësimin e Programit të UNMIK-ut për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Këto rekomandime duhen përkrahur si urgjente për shkak se pa dëshmi të besueshme nga dëshmitari, sundimi i ligjit në Kosovë do të mbetet i dobët dhe kriminelët e fuqishëm do të vazhdojnë t'i ikin ndëshkimit. Gjithashtu ekzistojnë edhe masa për sanksionimin e personelit nëse zbulojnë identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur ose nëse zbulojnë detaje të cilat mund të qojnë drejt zbulimit të identitetit të dëshmitarit. Nëse një prokuror ose gjykatës rrezikon fshehtësinë e dëshmitarit të mbrojtur, atëherë Këshilli Gjyqësor i Kosovës është kompetent që të shqiptoj masa disiplinore²²). Nëse shkelja bëhet nga një avokat, Oda e Avokatëve të Kosovës është kompetente, bazuar në dy dokumente: Ligjin mbi Avokatët dhe Ndihmën Ligjore (Gazeta Zyrtare e Kosovës 48/79) dhe Statusi i Odës së Avokatëve të Kosovës. Njohuria mbi këto masa duhet të ngritet dhe masat e nevojshme duhen marrë kundër atyre të që i shkelin institucionet e drejtësisë dhe sigurisë.

²¹ *Siguria dhe Mbrojtja e Dëshmitarëve në Kosovë: Vlerësimi dhe Rekomandimet*, Misioni i OSBE-së në Kosovë (Nëntor 2007), mund të gjendet në adresën:

http://www.osce.org/documents/cio/2007/11/27752_en.pdf , qasur së fundi me 9 nëntor 2007

²² Seksioni 7, UNMIK/REG/2005/52 Mbi Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që mund të gjendet në adresën:

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2005regs/RE2005_52.pdf , qasur së fundi me 9 nëntor 2007

4 Qeverisja dhe politika

4.1 Qeverisja dhe politika si nxitës të konfliktit

Pjesëmarrësit e seminarit shprehën huti mbi rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve të ndryshme, e në veçanti IPVQ-ve dhe administratës ndërkombëtare. Rritja e transferit së kompetencave nga UNMIK-u te IPVQ-të nënkuptoi që përgjegjësitë e ministrive kanë ndryshuar shpesh, dhe zyrtarët shpesh nuk i kanë të qarta rolet dhe obligimet e tyre. Kjo huti gjithashtu u mundëson përfaqësuesve të autoriteteve qeveritare vendore t'i ikin përgjegjësisë për vendimet dhe veprimet e tyre. Në të njëjtën kohë, nuk ka ndonjë mekanizëm që i mundëson publikut dhe institucioneve të Kosovës të mbajnë përgjegjës administratën dhe organizatat ndërkombëtare kompetente. Problemet e lidhura me shmangien nga përgjegjësitë (sidomos kur gjërat përkeqësohen), paqartësitë se cilat janë përgjegjësitë e tyre, dhe mungesa e mekanizmave të qartë për t'i mbajtur këto organe përgjegjëse, shpiejn drejt privimit të të drejtave në publik.

Puna e institucioneve dhe agjencive qeverisëse – lokale/komunale, të IPVQ-ve dhe ndërkombëtare – është jotransparente. Publiku nuk e ka të qartë se çfarë bëjnë autoritetet. Nuk ka informacione të mjaftueshme mbi aktivitetet, përgjegjësitë dhe projektet hulumtuese qeveritare dhe njerëzit nuk dinë si t'u qasen informacioneve ekzistuese. Gazetat mund të jenë një burim i rëndësishëm i informimit, por raportimi mund të jetë i kualitetit të dobët, hutues dhe i pamjaftueshëm. IPVQ-të gjithashtu nuk shihen si proaktive në ofrimin e informacionit ose kërkimin e mendimeve, gjë që u theksua në Graçanicë ku informimi mbi IPVQ-të është minimal, por interesimi i njerëzve për të ditur më shumë është i madh. Në këto situata, mungesa e informimit i pengon ata të cilët dëshirojnë të ndryshojnë marrëdhëniet e tyre me komunitetin shqiptar dhe në këtë mënyrë pengojnë edhe pajtimin dhe ndryshimet pozitive.

Ekzistimi i strukturave paralele ende mbetet një çështje kontradiktore. Aktualisht, institucionet e financuara nga Beogradi janë duke vepruar në komunitetet serbe në tërë Kosovën, duke ofruar kështu shërbime publike dhe duke i ndarë politikën dhe shërbimet shoqërore të serbëve të Kosovës nga pjesa tjetër e Kosovës. Në anën tjetër, ata ofrojnë një jetë kulturore dhe politike për ata të cilët dëshirojnë t'i mbajnë lidhjet me Beogradin, duke ofruar kështu shërbime vitale në vendet të cilat kanë nevojë për to dhe të cilat përndryshe mund të mos përfillen nga institucionet tjera. Në anën tjetër, fakti që ato ekzistojnë dhe efekti ekonomik dhe politik që kanë, konsiderohet nga shumë si nxitës i konfliktit në Kosovë. Për shembull, pagat e punëtorëve të strukturave paralele janë në përgjithësi më të mëdha se ato të

Fokus grupet në Graçanicë dhe Prizren u ankuan për përfaqësim të pamjaftueshëm të minoriteteve në institucionet qendrore të qeverisë. Në veçanti, dominonte një ndjenjë se përfaqësuesit e minoriteteve në qeveri nuk i kanë përfaqësuar interesat më të mira të komuniteteve minoritare që i përfaqësojnë.

paguara nga IPVQ-të (shih fusnotën 26), duke i bërë kështu njerëzit të ngurrojnë që të largohen nga sistemi paralel. Në të njëjtën kohë, sistemi paralel është pengesë për IPVQ-të që t'i shërbej të gjithë popullit të Kosovës: disa komunitete nuk kanë lidhje me strukturat kosovare, pasi që shërbimet e tyre ofrohen nga strukturat

paralele. Në disa nga këto komunitete, si në Graçanicë, strukturat paralele nuk shihen gjithmonë si struktura që i shërbejnë komuniteteve serbe të Kosovës. Për më shumë, këto struktura paralele konsiderohen nga shumë si të papërgjegjshme ndaj njerëzve në Kosovë e poashtu edhe ndaj insitucioneve në Serbi. Njerëzit, tash janë aq të varur nga strukturat paralele për ofrimin e shërbimeve dhe vendet e punës saqë janë të shqetësuar mbi të ardhmen e këtyre strukturave pasi të vendoset për statusin përfundimtar.

Ndarja e paqartë e kompetencave, roleve dhe përgjegjësive në mes IPVQ-ve dhe UNMIK-ut, dhe kompetencat jo adekuate në të gjitha institucionet qeverisëse, krijojnë mundësi për dështim në ofrimin e shërbimeve, për nepotizëm dhe korrupsion. Këto çështje janë një shqetësim shumë i madh për publikun e Kosovës dhe tregojnë mendimet e secilit për të gjitha nivelet e qeverisë.

"Korrupcioni shpie drejt qeverisjes së dobët, shërbime të dobëta për qytetarët dhe pakënaqësi me institucionet"
- Përfaqësues i OJQ-së nga Ferizaj

Pjesëmarrësit në hulumtimin për këtë raport shprehën shqetësim dhe huti në lidhje me procesin e decentralizimit, siç është propozuar në Planin e Ahtisaarit, i cili ofron mundësi për krijimin e komunave të reja dhe kompetenca të reja për disa shërbime në nivelin komunal. Për shembull, në rajonin e Gjilanit, ku ka fshatra me komunitete të përziera (si Cërnica, Stanishori, Koretini dhe Pasjaku), të intervistuarit shprehën shqetësimin se krijimi i komunave të reja do të shkaktoj probleme me transferin e dokumenteve personale (si patentëshoferi dhe dokumentet e identifikimit). Probleme të ngjashme me qasjen në dokumente tashmë janë ngritur në Mitrovicën jugore.

Për më shumë, procesi i decentralizimit përgjatë vijave etnike është duke krijuar një ndarje të thellë në mes komuniteteve. Disa nga këto çështje janë të lidhura me informacionet e paqarta mbi procesin e decentralizimit. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit nuk dukeshin se kuptonin se decentralizimi gjithashtu ofron një mundësi për qeverisje të përmirësuar dhe më të përgjegjshme në nivelin e qeverisjes lokale nëse bëhet sipas nevojave të qytetarëve.

4.2 Mundësitë për paqe në politikën dhe qeverisjen në Kosovë

Politika rreth diskutimeve mbi statusin përfundimtar dominon gjithkund, dhe një pjesë e madhe e kësaj është jashtë kontrollit të qytetarëve të thjeshtë. Përderisa kritikizmi i brendshëm ndaj IPVQ-ve dhe anëtarëve të Ekipit të Unitetit²³ duket të jetë zbutur, megjithatë ekzistojnë disa shembuj të mirë të kritikës dhe mbikqyrjes, si debatet televizive të organizuara nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe koalicioni i OJQ-ve lokale "Demokracia në Veprim" gjatë fushatës zgjedhore. Sidoqoftë, ekzistojnë disa probleme të qarta që dalin në sistemin politik të Kosovës që janë të lidhura me korrupsionin, tenderët jotransparent dhe praktikën e punësimit në nivelin vendor dhe komunal. Disa nga këto janë përkeqësuar nga vështirësitë e procesit të tranzicionit, dhe është e rëndësishme për të gjithë të përfshirët që të vazhdojnë me përpjekjet për përkrahjen e një sistemi qeveritar të përgjegjshëm dhe kompetent, që mund t'i shërbejë Kosovës në të ardhmen e largët – dhe jo të bllokohen vetëm për statusin përfundimtar.

²³ Ekipi i Unitetit është ekip negociues pesë-anëtarësh i cili përbëhet prej përfaqësuesëve të koalicionit qeveritar dhe partive opozitare, që merren me çështjen e statusit përfundimtar.

- **Kompetencat specifike** të IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe të misionit të mundshëm të Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP) **duhen qartësuar për popullsinë e Kosovës**. Gjithashtu, duhen krijuar mundësitë për të diskutuar këtë me IPVQ-të dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, në takime publike ku opinioni në mbarë Kosovën (e jo vetëm në Prishtinë) mund të diskutoj çështje të rëndësishme me përfaqësuesit e këtyre organeve. Kjo është mënyra e vetme me të cilën publiku mund të kuptoj se kë të mbajë përgjegjës për politikën dhe shërbimet publike, dhe gjithashtu është thelbësore për krijimin e një kulture të përgjegjësive politike për të ardhmen. Mungesa e dukshme e përgjegjësive së organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve paralele, dhe mekanizmat e dobët të përgjegjësive së IPVQ-ve, janë të dëmshme për sistemin e ardhshëm politik në Kosovë dhe këto duhet adresuar.
- Varësisht se çfarë ndodhë me 10 dhjetor, disa nga detajet e mandatit dhe përgjegjësitë të IPVQ-ve mund të mbesin të paqarta për muajt në vazhdim. Kjo komplikon përkrahjen e institucioneve të IPVQ-ve. Sidoqoftë, **IPVQ-të duhen përkrahur për të marrë një rol më udhëheqës në definimin e nevojave të tyre** dhe mënyrave të punës për fushat ku i kanë kompetencat e qarta. Për më shumë, **donatorët që ofrojnë këtë përkrahje duhet të bëhen më të kordinuar** dhe duhen shmangur përsëritjen e modeleve nga shtetet e ndryshme në pjesë përbërëse të IPVQ-ve, të cilat përfundimisht mund t'u shkaktojnë IPVQ-ve shumë rregullime institucionale kundërshtuese dhe të pamjaftueshme.
- Vendimi mbi fatin e strukturave paralele në tërë Kosovën është thelbësor për stabilitetin politik dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore, por gjithashtu është edhe çështje shumë e ndjeshme e cila përmban disa nga nxitësit e konfliktit të lidhur me identitetet. Çfarëdo vendimi mbi këtë çështje duhet të jetë **transparent, i këshilluar dhe duhet marrë parasysh ndikimi shoqëror, ekonomik dhe politik** për zbërthimin ose ruajtjen e këtyre strukturave.
- Në përgjithësi, **ofrimi i shërbimeve dhe decentralizimi** në tërë Kosovën janë mundësi reale për paqe nëse bëhen **bazuar në nevoja**, dhe nëse vendimet (dhe alokimet buxhetore) janë transparente dhe të përgjegjshme.

"Lëvizja e lirë është shumë më e mirë se që ka qenë, por disa njerëz ende nuk ndihen të sigurt për këtë çështje"

– përfaqësues i OJQ-së nga Graçanica

konfliktit në Kosovë

5 Çështjet shoqërore dhe kulturore

5.1 Çështjet shoqërore dhe kulturore si nxitës të

Ekzistojnë shumë ndarje në shoqërinë Kosovare, disa prej të cilave luajnë rolin e nxitësve të konfliktit dhe tensionit. Për shembull, gjatë diskutimeve të fokus grupeve, njerëzit nga vendet rurale rregullisht janë përshkruar si njerëz që nuk trajtohen me respektin e njëjtë si njerëzit nga vendet urbane, sidomos kur vie nevoja të qasja në institucionet ligjore. Në të njëjtën kohë, disa njerëz nga vendet urbane janë ankuar se të zhvendosurit nga fshatrat në qytet shpesh nuk i adaptohen jetës së qytetit.

Pasi që ky hulumtim nuk është fokusuar specifikisht në çështjen e të drejtave të gruas, ekzistojnë çështje të qarta të lidhura me konflikt që i takojnë specifikisht gruas dhe të cilat kanë nevojë për hulumtim më të fokusuar dhe detajizuar. Në kontekstin e kësaj analize, vetëm në rajonin e Pejës dhe Gjakovës (ku numri i madh i grave të veja prej luftës 1998-99 i jep një zë më të fuqishëm gruas) u shpreh shqetësimi për mbrojtjen e pamjaftueshme të të drejtave të gruas. Një grua në një fokus grup në Gjakovë përmbledhi problemin për rajonin e saj: “Unë punoj me femrat në vendet rurale, sidomos me femrat të cilat udhëheqin familjen. Shumica e tyre qëndrojnë në shtëpi, janë të kufizuara dhe nuk kanë të drejta pronësore, dhe vjehrrit e tyre i marrin vendimet. Ato zakonisht nuk bëjnë asgjë për shkak se nuk janë të sigurta dhe nuk kanë të drejta.”

Ndarja etnike mbetet një nga ndarjet kyçe në shoqërinë e Kosovës, dhe kjo sepse njerëzit janë të definuar ekskluzivisht sipas etnitetit të tyre, e jo sipas identiteteve tjera, si profesioni, interesi, dhe gjinia, dhe pothuajse nuk ka lidhje kulturore në mes komuniteteve, sidomos në mes komuniteteve të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Komunitetet e ndryshme etnike definojnë “tjerët” me stereotipe negative, por njerëzit gjithashtu përdorin stereotipe pozitive për të definuar etnitetin e tyre. Kjo do të thotë se shumë nga fjalimet shoqërore janë bazuar në identitetin etnik, i cili kur perceptohet si çështje ndarëse zvogëlon hapësirën që njerëzit të diskutojnë mbi të përbashkëtat e tyre përkundër dallimeve etnike.

Ka shumë debate dhe diskutime pozitive brenda grupeve etnike. Sidoqoftë, ende ka shumë presion të brendshëm brenda disa komunave (sidomos në komunitetet serbe në disa enklava, por gjithashtu edhe në komunitetet e shqiptarëve përkrahës të rrugës së ashpër) për njerëzit të cilët nuk dëshirojnë të angazhohen në strukturat e përbashkëta ose ‘në anën tjetër’. Ekziston një vështrim i shumë pjesëmarrësve të këtij hulumtimi se politikanët nga të gjitha anët nuk janë duke i lejuar debatet në mënyrë që të paraqesin një front të përbashkët dhe të njëjtë, duke supozuar të përforcojnë pozitën e tyre politike të nivelit të lartë, sidomos duke iu referuar bisedimeve për statusin përfundimtar. Kjo shpie drejt frustrimit se disa argumente janë duke u injoruar. Për shembull, interesat dhe opinionet e serbëve në enklava, komunitetet e përziera, dhe komuna e Shtërpcës me shumicë serbe janë shumë të ndryshme, por ekziston një ndjenjë se këto dallime janë duke u injoruar pasi që Beogradi dhe disa politikanë serbë të Kosovës perceptohet se veprojnë për interesat e tyre e jo të atyre që i kanë zgjedhur.

Migrimi në dhe brenda Kosovës brenda dekadës së kaluar ka rezultuar në ndryshim të popullsisë: ‘të sapoardhurit’ shpesh shihen me dyshim dhe injorancë por shpesh janë të varfër me shumë pak përfaqësim dhe qasje në shërbimet qeveritare. Shumë njerëz ende nuk janë kthyer në shtëpitë e tyre pasi që janë larguar nga to në vitin 1999 dhe 2004, dhe ende ka refugjatë nga lufta e Bosnjës dhe Kroacisë, të cilët jetojnë në Kosovën veriore.

Liria e lëvizjes ende mbetet një problem për shumë njerëz të Kosovës, por është përmirësuar shumë që prej vitit 1999. Për më shumë, shumë njerëz argumentojnë se perceptimi është më i keq se realiteti. Megjithatë, komunitetet minoritare në veçanti shpesh janë të frikësuar të udhëtojnë larg nga shtëpitë e tyre pasi që bie terri. Një çështje e veçantë që pengon lirinë e lëvizjes janë targat e veturave. Për shembull, në enklavën serbe në Graçanicë shumica e veturave kanë targa të

"Kravata gjithmonë do të ketë më shumë përparësi se plisi"
- mashkull nga Prishtina

regjimit para vitit 1999 dhe nuk i kanë targa me KS. Disa njerëz kanë refuzuar të ndërrojnë targa të tyre të regjistrimit për shkak se kjo do të nënkuptonte njohjen e autoriteteve të institucioneve kosovare, por të tjerët dëshirojnë t'i ndërrojnë targa të tyre, por nuk mund ta bëjnë këtë për shkak se qendrat e regjistrimit të veturave kërkojnë dëshmi mbi pagesën e faturave të energjisë elektrike²⁴. Në qytetin e Mitrovicës, targa KS përdoren në pjesën jugore dhe targa të Serbisë përdoren në pjesën veriore. Shumë njerëz mendojnë se nuk është e mundur të kalohet lumi Ibër (i cili kalon nëpërmes qytetit) me targa të kundërta për shkak se ata frikësohen se si mund të reagojnë përkrahësit e rrugës së ashpër në anën tjetër të lumit. Si pasojë, njerëzit nuk e kalojnë lumin për shkak se nuk kanë targa neutrale (si ato të përdorura nga organizatat ndërkombëtare) edhe pse mund të dëshirojnë të udhëtojnë në pjesën tjetër të Kosovës nëse do të kishin mundësinë.

*"Në Pejë njerëzit ndjehen të pasigurt.
Nuk ka liri të lëvizjes pasi të bie terrori"
– përfaqësues të OJQ-së nga Peja*

Edhe brenda komuniteteve me etni të njëjta njerëzit jo gjithmonë ndihen të sigurt kur largohen nga shtëpitë e tyre gjatë natës. Në Pejë dhe Gjakovë, shumë njerëz frikësohen të jenë jashtë natën për shkak të aktiviteteve të grupeve kriminale dhe policisë së dobët.

5.2 Mundësitë për paqe në sferat shoqërore dhe kulturore

Në qendrën e dinamikës së konfliktit në Kosovë është ndarja në mes komuniteteve të ndryshme. Përkundër viteve përpjekje për krijimin e paqes nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare²⁵, këto tensione ende ekzistojnë dhe ende ekzistojnë komunitete ku kontakti me 'anën tjetër' është thjeshtë i papranueshëm. Mund të thuhet se për momentin, pasiguria e vazhdueshme mbi statusin e ardhshëm politik të Kosovës është duke kontribuar në mbajtjen e këtyre ndarjeve, pasi që kjo lejon izolimin e vazhdueshëm të komunitetit serb të Kosovës nga strukturat e Beogradit duke shpresuar për një zgjidhje e cila do të mundësojë mbajtjen e lidhjeve me Beogradin. Në të njëjtën kohë, shumica shqiptare duket të jetë e besueshme – dhe jokomprometuese – që Kosova do të bëhet e pavarur. Ndikimi i veçantë i bisedimeve mbi statusin përfundimtar është elaboruar në seksionin 2.1. Në këtë seksion, rëndësi e veçantë i është kushtuar asaj se çfarë mund të bëhet ndërkohë, si dhe pas statusit përfundimtar në mënyrë që të fillohet me adresimin e disa nga këtyre nxitësve të konfliktit shoqëror dhe kulturor.

- Në mënyrë që të zvogëlohen ndarjet në mes popullsisë rurale dhe urbane, dhe zhvillimi i pabarabartë i komunave, institucionet vendore dhe ndërkombëtare

²⁴ Me 4 korrik 2007, u nënshkrua një memorandum i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) sipas së cilës kërkohet dëshmi e pagesës së faturave të energjisë elektrike në mënyrë që të mund të merren targa të veturave KS. Në disa raste, veçanërisht për serbët e Kosovës, kjo shumë shkon në mijëra euro, sepse disa fatura të energjisë elektrike nuk janë paguar që nga viti 1999. Në këtë mënyrë, njerëzit janë duke u ndëshkuar dy herë për një shkelje. Mund të gjendet në adresën: http://www.mem-ks.com/index.php?option=com_content&task=view&id=137&Itemid=102&lang=en

²⁵ Shih raportin, *A ka Bërë Ndonjë Ndryshim në Kosovë Ndërtimi i Paqes? Studim i efikasitetit të Ndërtimit të Paqes dhe Parandalimit të Konfliktit: mësimet e marra nga Trazirat e Marsit 2004 në Kosovë* (Qershor 2006), CDA Collaborative Learning Projects dhe CARE International, për një vlerësim të thellë të përpjekjeve për ndërtimin e paqes në Kosovë.

(përfshirë IPVQ-të, UNMIK-un/një mision të mundshëm të ESDP-së, agjencitë e jashtme qeveritare dhe OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare) duhet të kenë më shumë kujdes që të sigurohen se **puna dhe investimet e tyre janë të përcaktuara për komunitetet dhe komunat, jo vetëm në Prishtinë**. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet që njerëzit e aftë janë në dispozicion në tërë Kosovës dhe mund të lidhen me ndonjë proces të decentralizimit. E njëjta qëndron edhe me alokimet buxhetore në komunat e ndryshme të Kosovës, të cilat duhet të adaptohen për të përkrahur këtë qëllim.

- Si duket ekziston një nevojë reale për të përkrahur **më shumë diskutime mbi çështjet 'ndëretnike'**. Disa pjesëmarrës shprehën frustrimin që çdokush e njëjti ndarjen ndëretnike si çështje, por mungojnë diskutime të qëndrueshme dhe angazhuuese mbi aspektet e ndryshme të tensioneve ndëretnike dhe se si duhen adresuar ato. Ekzistojnë disa fusha të mundshme në të cilat kjo çështje mund të adresohet, përfshirë:
 - **Rishikimin e sistemit të edukimit** për të përfshirë më shumë diskutime të hapura për konceptin e diskriminimit, barazisë, të drejtave të njeriut, etj., dhe rishikimin e programit mësimor për të paraqitur perspektiva të ndryshme të ngjarjeve historike si kundërvënie ndaj mësimi propagandistik në shkolla.
 - **Vazhdimin e adresimit të lirisë së lëvizjes**, përfshirë adresimin nëpërmjet çështjes së targave të regjistrimit dhe vështirësive të marrjes së dokumenteve. Për shembull, do të ishte shumë ndihmëse nëse do të largohej fatura e energjisë elektrike nga regjistrimi për marrjen e targave të regjistrimit të veturës, në mënyrë që ata të cilët dëshirojnë të udhëtojnë jashtë vendbanimeve të tyre ta bëjnë këtë më lehtë.
 - Media ka një rol shumë të rëndësishëm në informimin publik mbi çështjet reale të politikave dhe politikës në mënyrë që të gjitha informacionet e IPVQ-ve dhe UNMIK-ut të arrijnë tek të gjitha pjesët e popullsisë dhe të jenë në dispozicion në të gjitha gjuhët (të përkthyer mirë). Në të njëjtën kohë, ekziston një mundësi reale **për përmirësimin e marrëdhënieve në mes komuniteteve në kuptimin e radio stacioneve lokale**, të cilat mund të ndajnë informacionet e njëjta në të gjitha vendet. Kjo do të përfshinte shembuj pozitiv se si disa komunitete të përziera në Kosovë kanë gjetur mënyra për t'i zgjidhur këto probleme së bashku dhe se bashkëpunimi i tyre është i suksesshëm. Disa media janë duke bërë punë të mirë në këtë drejtim, si bashkëpunimi në mes Rrjetit Ballkanik të Raportimit Hulumentues (BIRN) dhe B92-shit, puna e Radio Kamenicës dhe radio programit "Bla Bla Café" të Komunikimit për Zhvillim Shoqëror.²⁶
- Monumentet janë gjithmonë pjesë e ndjeshme e tranzicionit të pas-konfliktit, por kjo është një çështje komplekse në Kosovë, e cila duhet të trajtohet me kujdes në mënyrë që të gjitha komunitetet të ndjejnë se tregimi i tyre është portretizuar, por që ata gjithashtu mund të shohin përpara dhe të punojnë për pajtimin me komunitetet tjera.

²⁶ Shih *Raportin e vlerësimit mbi projektet e rrjetit të Medienhilfe në Maqedoni dhe Kosovë* (Shtator 2006), Mark Thompson, mund të gjendet në adresën: <http://www.medienhilfe.ch/fileadmin/medienhilfe/mh-Evaluation2006.pdf>, qasur me 9 Nëntor 2007, për vlerësimin e disa sukseseve në këtë fushë.

6 Ekonomia dhe jetesa

6.1 Ekonomia dhe jetesa si nxitës të konfliktit në Kosovë

Në të gjitha rajonet e Kosovës, me përjashtim të Prishtinës dhe Mitrovicës veriore, papunësia nga pjesëmarrësit u perceptua si një nga nxitësit kryesor të konfliktit, pjesërisht për shkak të varfërisë së përgjithshme dhe vetërespektit të ulët, dhe pjesërisht për shkak se pa të ardhura është e pamundur të udhëtohet dhe shoqërohet, gjë që kontribuon në mërzinë, frustrimin dhe izolimin në rritje e sipër. Edhe procesi i privatizimit gjithashtu shkakton papunësi në disa vende. 'Punë për jetë' është duke u zhdukur pasi që ndërmarrjet shoqërore (NSh) janë shitur dhe punëtorët e tyre janë larguar nga puna. Një fabrikë në Prizren është shembull i këtij trendi. Tremijë njerëz kanë humbur punën e tyre kur kjo fabrikë është shitur dhe ka ndryshuar natyrën e punës.

Në të njëjtën kohë, nepotizmi në praktikën e punësimit mund të nënkuptoj që njerëzit e pakualifikuar janë punësuar për shkak të lidhjeve familjare, duke ulur kështu më shumë mungesën ekonomike të ndërmarrjeve dhe duke shkaktuar mllëf në mesin e njerëzve që nuk kanë lidhje familjare. Kjo çështje është paraqitur sidomos në Prishtinë, ku u tregua për njerëzit të cilët punësohen në punët që nuk janë të kualifikuar.

Derisa paratë nga jashtë në fakt mbështesin shumë familje në Kosovë, dhe pagesat mbi mesatare nga strukturat paralele të financuara nga Beogradi²⁷ u ofrojnë disa njerëzve standarde relativisht të mira, pamundësia që qeveria qendrore të tatimoj këto burime të të ardhurave (si dhe ekonomisë jozyrtare), nënkupton që ka pak mundësi që kjo pasuri t'u rishpërndahet atyre që kanë më shumë nevojë për to. Për shembull, pensionet thuhet nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e ushqimit²⁸ dhe pagesat e ulëta, sidomos për punëtorët e sektorit publik, janë konsideruar nga pjesëmarrësit e seminarit të jenë një faktor i cili i kontribuon korrupsionit. Korrupsioni në institucionet qeveritare është në favor të të pasurve, të cilët mund t'i qasen shërbimeve policore, ligjore, shëndetësore dhe edukuese më shpejt dhe më saktë, duke mbështetur dhe rritur ndarjen e shtresave të shoqërisë dhe duke ngritur nivelin e pabarazisë.

Standardet e ulëta të jetesës janë të lidhura me pagat e ulëta për ata të cilët janë të punësuar, dhe me çmimet e larta për artikujt themelor si buka, vaji i gatimit dhe qumështi. Përfaqësues të OJQ-ve lokale përmendën se Ferizaj është regjioni më i varfër në Kosovë sipas Bankës Botërore, dhe ekziston një perceptim se kjo Ferizaj si komunë nuk merr pjesën e saj të duhur nga buxheti i Kosovës, duke shtuar kështu mllëfin ndaj IPVQ-së.

"Ne marrim 40 euro pension në muaj. Si mund të jetojmë me këto para?"

- mashkull 55 vjeçar nga Prishtina

²⁷ Disa marrin paga nga institucionet e financuara nga Beogradi dhe institucionet e Kosovës (për shembull në sektorët e shëndetësisë dhe edukimit).

²⁸ Pensioni mujor për ata që ishin kontribues në sistemin e kaluar do të ngritet nga 40€ në 75€ që nga 1 janari 2008.

Perceptimi për keqmenaxhimin e infrastrukturës ekonomike

Kosova është një shoqëri në tranzicion, dhe kështu ekonomia e saj është duke kaluar nëpër ndryshime të thella strukturore si privatizimi. Në të njëjtën kohë, kapaciteti i infrastrukturës së saj (për shembull, rrjetet e energjisë elektrike dhe ujit) është i dobët dhe është si pengesë për zhvillimin ekonomik. Ajo që keqëson më shumë këtë është perceptimi për keqmenaxhimin ekonomik dhe infrastrukturës së saj.

Problemet me politikat dhe praktikën e disa kompanive të shërbimeve komunale janë përmendur si nxitës të konfliktit nga pjesëmarrësit e seminareve dhe të intervistuarit e fokus grupeve, sidomos Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Ndërprerjet e rregullta dhe të parregullta të energjisë elektrike, furnizimi i pabarabartë në Kosovë (që është e mundur se mund të keqësohet gjatë dimrit) dhe vështirësitë me pagesën e faturave të energjisë elektrike shkaktojnë mlllef dhe frustrim, shpesh të drejtuar kundër komuniteteve tjera e jo KEK-ut (edhe pse kohëve të fundit po i drejtohen KEK-ut secilën herë më shumë). Keqmenaxhimi i rrjetit të energjisë elektrike krijon kushte për vjedhje të shpeshtë dhe të shtrirë në Kosovë të energjisë elektrike, duke ulur kështu efikasitetin e KEK-ut dhe duke i kaluar shpenzimet tek klientët. Siç edhe tha një përfaqësues i një OJQ-je nga Gjakova, "Menaxhimi i dobët i KEK-ut shpie tek problemet shoqërore". (Shih seksionin 5.31 dhe 6.2 për më shumë mbi çështjet e energjisë elektrike.)

Programi i privatizimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) shpesh është përmendur si i padrejtë, i keqmenaxhuar dhe i ndikuar politikisht. Shitja e pronës qeveritare të pronarët komercial shpesh ka shkaktuar mlllef në shoqëritë post-komuniste, por në Kosovë korrupsioni i perceptuar në procesin e tenderimit është duke rritur mosbesimin në qeveri dhe është duke i zgjeruar ndarjet e shoqërisë në mes të atyre "që kanë" dhe "që nuk kanë".

6.2 Mundësitë për paqe në sferën e ekonomisë

Sfidat ekonomike të Kosovës janë rritur nga lufta dhe pasiguria pasuese mbi statusin përfundimtar politik të saj. Kjo ka kontribuar në papunësinë e madhe, e cila rrit frustrimin e njerëzve në lidhje me vonesat që bëhen për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Derisa ekzistojnë disa hapa të cilët veç mund të merren për të filluar adresimin e disa nxitësve ekonomik të konfliktit, gjithashtu është e rëndësishme të dihet se pritjet e njerëzve për përfitimet ekonomike të pavarësisht të mundshëm të Kosovës janë shumë të larta dhe kanë nevojë të adresohen në muajt e ardhshëm pasi të vendoset mbi të ardhmen politike të Kosovës.

- Mënyra me të cilën është drejtuar privatizimi mund të përmirësohet në mënyrë që të nxitet hapja e vendeve të punës dhe të sigurohet që **procesi i privatizimit të bizneseve është tërësisht transparent**. Së pari, ka nevojë për më shumë transparencë në procedurat e tenderimit dhe për më shumë vëmendje në verifikimin se pronësia e tokës në të cilën ndodhet biznesi është duke kaluar nëpër një proces transparent dhe të pranueshëm. Së dyti, disa lloje të privatizimit të NSH-ve janë me 'spin-of', që ofrojnë nxitje të mirë për pronarët e rinj që të vazhdojnë me biznesin e njëjtë, të mbajnë të njëjtit punëtorë dhe të investojnë në këtë biznes²⁹. Sidoqoftë, **ka mungesë të mbikëqyrjes dhe**

²⁹ "Metoda e Spin-ofit Special të privatizimit shton dy kushte në kriterin çmimi më i lartë: Niveli i punësimit dhe shpenzimet kapitale. Si rezultat, pas pagesës së çmimit ofertues fitues, ofertuesi fitues

vlerësimit të ndërmarrjeve të privatizuara me spin-of special. Duke pas parasysh se papunësia është përmendur shpesh si nxitës kyç i konfliktit gjatë këtij hulumtimi, krijimi i më shumë vendeve të punës ka potencial të ulë mundësinë e një konflikti të ardhshëm. Në lidhje me këtë, është me rëndësi **që më shumë informacione të jenë në dispozicion të publikut të gjerë mbi rolin dhe mandatin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM)** në mënyrë që të dihen pritjet reale, por gjithashtu edhe të sigurohet që AKM-ja është e përgjegjshme për veprimet e saj dhe se kompetencat e saj janë të ndara qartë nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP).

- Në mënyrë që të stimulohet rritja ekonomike, një fushë tjetër që duhet përmirësuar është **përkrahja më aktive e prodhimit lokal**, që përfshinë punën me tarifa të lira për import dhe tarifa të larta për eksport, si dhe gjetjen e mënyrës së stimulimit të bujqësisë dhe prodhimit kosovar në mënyrë që shumë artikuj kryesor të jenë vendor. Gjithashtu ekziston edhe nevoja për **inkurajimin më të madh të investimeve të jashtme dhe vendore**, që përfshinë adresimin e problemeve me shërbimet e energjisë elektrike (që do të ruante paratë e bizneseve dhe do të inkurajonte bizneset e reja që të krijohen), rëndësinë e vendosjes së statusit përfundimtar të Kosovës³⁰ dhe sigurimin që mosmarrëveshjet pronësore janë trajtuar sa më shpejtë që është e mundur dhe shënimet t'u ofrohen investuesve potencial. Ndoshta ekziston edhe nevoja që të vendosen disa 'garancione' në mënyrë që të inkurajohen investuesit, si për shembull që të gjitha pronësitë private do të respektohen, dhe të gjitha bankat të ofrojnë kushte më të mira kredie, sidomos për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që do të mundësonte investime në ekonominë e Kosovës. Politikat aktuale të institucioneve financiare e bëjnë më të vështirë që disa biznese të vogla të zhvillohen më shumë.
- Lidhur me çështjen e cekur më lartë, gjithashtu ekziston një nevojë **për të përcjellë më mirë ndikimin shoqëror të ngritjes së çmimeve për artikujt kryesor**, sidomos për ata që kanë të ardhura fikse, siç janë pensionistët.
- Shumë pjesëmarrës në procesin e analizës së konfliktit përmendën ekonominë informale, e cila ofron një jetesë të rëndësishme për shumë njerëz në Kosovë, sidomos për personat e zhvendosur brenda vendit në disa vende. **Përkrahja e ekonomisë informale** mund të jetë një mundësi që të sigurohet që këta njerëz kanë një mënyrë të mbajnë veten e tyre dhe të rrinë larg varfërisë. Çfarëdo iniciative për të trajtuar tregtinë informale (si futja e saj në ekonominë zyrtare nëpërmes tatimeve dhe licencimit, ose presioni në tregtarët jozyrtar) duhet të ketë këtë parasysh dhe duhet gjetur zgjidhje të cilat janë këshilluar më parë dhe janë të ndjeshme sidomos për nevojat e atyre që janë prekur nga lufta, dhe e gjithë kjo në mënyrë që të përkrahet rikthimi e njerëzve.
- Vështirësitë me energji elektrike janë duke e penguar ekonominë e Kosovës, dhe gjithashtu duket t'i largojnë investimet e huaja dhe vendore, dhe kështu

do të ketë dy vite për të implementuar punësimin e zotuar dhe shpenzimet kapitale në kompaninë e re." *Privatizimi me Spinof Special*, Ardian Hackaj, Drejtor i Departamentit të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes, Divizioni SOE i AKM-së, mund të gjendet në adresën http://www.euinkosovo.org/uk/express/express_article.php?cat=49&id=119&eniid=12 (qasur së fundi me 9 nëntor 2007)

³⁰ Mendimet janë të ndara mbi atë se sa do të ndihmonte zgjidhja e statusit të Kosovës në inkurajimin e investimeve, por adoptimi i nxitjeve ose ligjeve më të qarta biznesore dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve – lehtësimet pas një statusi të zgjidhur – me siguri do të ndihmonte.

kanë një ndikim të rëndësishëm në mundësinë e Kosovës për të arritur rritjen ekonomike të nevojshme për një shoqëri të qëndrueshme. Shumë vende në veri të Kosovës kanë furnizim mesatarisht të mirë më energji elektrike për shkak të përkrahjes nga Beogradi, dhe nëse vazhdohet me këtë trend (sidomos pas përcaktimit të statusit përfundimtar), ekziston rreziku që dallimet në furnizimin me energji elektrike mund të kontribuojnë në ndarjet dhe mllëfin në mes tyre.³¹ Kjo duhet shmangur **duke e adresuar furnizimin me energji elektrike në tërë Kosovën sa më shpejtë që është e mundur** dhe duke e informuar publikun mbi atë se çfarë është duke u bërë dhe mbi periudhën kohore reale kur pritet që përmirësimet të materializohen.

- Aktualisht, borxhet për energji elektrike i janë mbledhur një shtëpie ose banesë e jo banorit të asaj shtëpie ose banesë, që nënkupton se njerëzit nuk mund të paguajnë faturat e papaguara të energjisë elektrike vetëm për kohën gjatë të cilës kanë jetuar aty. Kjo ndëshkon disa nga shtresat më të varfra të shoqërisë. Nëse do t'u lejohej njerëzve **të paguajnë vetëm borxhin që u është mbledhur atyre**, do të ishte përfituese për këto shtresa më të varfra të shoqërisë.
- Strukturat paralele të financuara nga Beogradi aktualisht ofrojnë punësim dhe të ardhura për një numër të njerëzve në komuna të ndryshme. Çfarëdo plani i ardhshëm për trajtimin e këtyre strukturave duhet të **konsideroj ndikimet ekonomike dhe se si këto ndikime mund të reflektojnë në marrëdhëniet në mes (dhe brenda) komuniteteve të ndryshme.**

7 Përfundim

Në kërkesën dhe shënimet e brengave dhe vështrimeve të një mostre të njerëzve nga komunitetet e Kosovës për një numër të çështjeve të lidhura me sigurinë, ky raport identifikon nxitësit potencial të konfliktit dhe sugjeron mundësi për paqe që në mënyrë direkte lidhet me nevojat dhe përvojat e komuniteteve të përfshira në hulumtim. Në një vend me opinione dhe interesa të ndryshme siq është Kosova, siguria është prioritet, përkundrazi mundimet për t'u pajisur me të shpesh janë treguar afatshkurta; është kritike që ata të cilët janë të prekur më së shumti kanë një zë në dizajnimin dhe zbatimin e politikave për siguri.

Në mënyrë që të dizajnohen intervenime të sigurisë që fokusohen në nevoja dhe intervenime, të cilat ndërtohen në mundësitë për paqe dhe që i shmangen shkaktarëve të konfliktit, komuniteti ndërkombëtar, agjensionet e donatorëve dhe IPVQ-të duhet të mundohen t'i përfshijnë komunitetet në një proces pjesëmarrës që të identifikojnë fushat prioritare për aksion. Duke hulumtuar dhe analizuar nevojat lokale dhe duke i reflektuar ato në strategjitë e fondeve dhe dizajnimin të programeve, institucionet vendore dhe ndërkombëtare mund të punojnë në bashkëpunim me komunitetet lokale për të krijuar një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme.

³¹ Gjatë dimrave të mëparshëm, kjo ndarje ishte e dukshme, sidomos me krijimin e planit të zonave ABC nga KEK-u, i cili ndëshkonte komunitetet e varfra dhe rurale. Edhe pse ky plan ishte bazuar në nivelet e pagesës së faturave, efekti i tij në praktikë krijoi një ndarje në mes të komuniteteve etnike dhe rurale/urbane, që përfundimisht çoi drejt ndërprerjes së planit ABC.

Aneksi A: Metodologjia

Kjo analizë është ndërmarrë nga një rrjet i gjerë i organizatave joqeveritare. Projekti është menagjuar nga Forumi për Iniciativa Qytetare dhe Saferworld, dhe analiza u ndërmorrë së bashku me nëntë OJQ lokale në Kosovë. Këto OJQ ishin:

- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (CCSD) (me zyre në Mitrovicë)
- Communication for Social Development (CSD) (me zyre në Graçanicë)
- Community Building Mitrovica (CBM)
- Qendra për Zhvillimin e Komunitetit të Biznesit (CBDC) (me zyre në Gjakovë)
- Iniciativa për Progres (INPO) (me zyre në Ferizaj)
- Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC) dhe Rrjeti Rinor i Gjilanit (me zyre në Gjilan)
- Këshilli për Paqe dhe të Drejta të Njeriut (PHRC) (me zyre në Prizren)
- Syri i Vizionit (me zyre në Pejë)

Analiza u bazua në masë të madhe në metodologjinë e Vlerësimit Strategjik të Konfliktit, të Departamentit të Britanisë së Madhe për Zhvillim Ndërkombëtar.³² (DFID). Qasja fokusohet në analizimin dhe lidhjen e çështjeve shoqërore, ekonomike, politike dhe të sigurisë, të cilat shkaktojnë ose mund të shkaktojnë konflikt në një kontekst të caktuar. E njëjta shqyrton interesat e palëve të ndryshme, dinamikën e konfliktit dhe reagimet aktuale ndaj tij.

Kjo analizë ka përdorë një qasje gjithëpërfshirëse për të kuptuar sa më shumë çështjet të cilat janë duke shkaktuar tensione ose ndarje në nivelet komunale dhe lokale. Hulumtimi është bërë në mes 14 shtatorit dhe 25 tetorit, dhe u zhvillua sipas hapave të shënuar mëposhtë.

Hapi 1: Identifikimi i nxitësve të konfliktit në tërë Kosovën

Tri seminare janë mbajtur për të identifikuar nxitësit e konfliktit në tërë Kosovën në kategoritë politika dhe qeverisja; ekonomia dhe jetesa; siguria dhe drejtësia; dhe shoqëria e kultura. Seminari i parë pati pjesëmarrës nga Shërbimi Policor i Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, i dyti përfaqësues të OJQ-ve ndërkombëtare të cilat tanimë kanë ndërmarrë një lloj të analizës së konfliktit, dhe i treti pjesëmarrës nga OJQ-të rajonale në Kosovë.

Hapi 2: Identifikimi i nxitësve të konfliktit në nivelin rajonal brenda Kosovës

Seminaret janë mbajtur në Gjakovë, Gjilan, Mitrovicën veriore, Mitrovicën jugore, Graçanicë, Prizren, Ferizaj, Pejë dhe Prishtinë, nga OJQ-të rajonale dhe pjesëmarrës ishin përfaqësues të shoqërisë civile nga rajoni i gjerë. Ata ndoqën të njëjtën mënyrë si lidhja e konfliktit në mbarë Kosovës, duke lidhur kështu nxitësit e konfliktit në nivelin rajonal brenda Kosovës.

Hapi 3: Fokus grupet

Fokus grupet janë mbajtur në të gjitha rajonet e Kosovës dhe kishin për qëllim të përfshijnë sa më shumë që është e mundur grupe të shoqërisë civile të Kosovës. Të

³² Siç është cekur në *Zhvillimin e vlerësimeve të konfliktit: Shënime udhëzuese*, Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID) i Mbretërisë së Bashkuar (2002). Mund të gjendet në adresën: <http://www.dfid.gov.uk/pubs/files/conflictassessmentguidance.pdf>

mbajtura veq e veq aty ku ishte e duhur, fokus grupet përbëheshin nga komunitete të ndryshme etnike (shqiptar, serb, goran, turk, rom, ashkali, boshnjak), meshkuj dhe femra, njerëz me profesione të ndryshme dhe njerëz të moshave të ndryshme. Në përgjithësi, janë mbajtur 16 fokus grupe, të organizuara nga OJQ-të rajonale.

Këto fokus grupe shqyrtuan çështjet rreth qasjes në drejtësi për qytetarët e thjeshtë dhe që të gjitha ndoqën një format të njëjtë. Pjesëmarrësit e fokus grupeve në veçanti komentuan mbi përvojat e tyre me strukturat e sigurisë dhe drejtësisë (sistemet gjyqësore, policinë, Ombudspersonin, zyren e prokurorit), vepruesit në sektorin e drejtësisë (avokatët, organizatat për përkrahjen e viktimave, planet për mbrojtjen e viktimave) dhe përvojat me sistemet zyrtare dhe jozyrtare të drejtësisë (si dëshmitarët, viktimat e krimit, kriminelët).

Hapi 4: Intervistat

Tetë OJQ-të rajonale dhe FIQ-i në Kosovë ndërmorën secila disa intervista me veprues relevant në sektorin e drejtësisë. Këto përfshinë përfaqësues të Ombudspersonit, gjyqtarë, përfaqësues nga zyra e prokurorit, policë, zyrtar gjyqësor, personeli i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe përkrahjes së viktimave, OJQ të specializuara, media lokale, përfaqësues të autoriteteve komunale, ekspertë ligjor dhe shumë të tjerë.

Hapi 5: Seminari i komenteve

Të gjitha këto informacione u mblodhën dhe u paraqitën në një seminar të udhëhequr nga FIQ-i. OJQ-të rajonale i paraqitën gjetjet e tyre kryesore njëra tjetrës dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Shërbimit Policor të Kosovës.